Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

# RAPORTI VJETOR I INSPEKTIMEVE 2022

# PËRMBAJTJA


- **PËRMBLEDHJE**

- **HYRJE**

- **QËLLIMI DHE METODOLOGJIA**

1. **DREJTORIA E KOORDINIMIT DHE MONITORIMIT TË INSPEKTIMIT**
   1.1 Inspektime, ri-inspektime dhe monitorime.
   1.2 Masa Administrative.
   1.3 Inspektime të kryera gjatë vitit 2022 sipas fushave të inspektimeve.
      1.3.1. Inspektime Sanitare.
         1.3.1.1. Inspektime Shëndetësore.
         1.3.1.2. Inspektime Sanitare.
      1.3.1. Inspektime të Tjera Shëndetësore.

2. **DREJTORIA E FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**
   2.1 Sektori i Financës
   2.2 Sektori i Shërbimeve të Brendshme
   2.3 Sektori Juridik

3. **ARRITJET E INSPEKTORATIT SHTETËROR OBJEKTIVAT PËR VITIN 2023**

4. **TREGUESIT E EFEKTIVITETIT TË ISHSH GJATË VITIT 2022**

- **SHTOJCA**

  - BAZA LIGJORE E VEPRIMTARISË SË ISHSH

# INSPEKTORATI SHTETËROR SHËNDETËSOR
# RAPORTI VJETOR 2022

## PËRMBLEDHJE

Materiali në vijim është një analizë e hollësishme e punës dhe aktivitetit të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) gjatë vitit 2022.

Puna dhe aktiviteti i ISHSH gjatë vitit 2022 janë kryer bazuar në përvojën më të mirë të institucionit tonë në vite dhe duke pasur në synim funksionimin e një institucioni që i përgjigjet kërkesave për mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe është në shërbim të tyre.

Në momentet kryesore të inspektimeve, ri-inspektimeve dhe monitorimeve të vitit 2022 mund të përmenden:

- Inspektimi i spitaleve publike dhe jo publike.
- Inspektimi i shërbimeve shëndetësore parësore publike dhe jo-publike (qendër mjekësore, kabinet mjekësor, shërbim laboratorik dhe kabinetet imazherike).
- Inspektimi i klinikave dhe laboratorëve stomatologjikë publike dhe jo- publike.
- Inspektime për akreditimin e institucioneve shëndetësore.
- Inspektimi higjieno-sanitar i institucioneve arsimore parashkollore, shkollore, universitare dhe konvikteve në funksion të këtyre institucioneve.
- Inspektime para dhe gjatë sezonit turistik.
- Inspektimi i subjekteve të furnizimit me ujë të pijshëm.
- Inspektimi ndërmarrjeve për kujdesin dhe sigurinë e shëndetit në punë.
- Inspektim për institucionet e ekzekutimit të dënimeve të veprave penale, paraburgimit dhe komisariatet e policisë.
- Inspektime në shtëpitë e të moshuarve publike dhe jo publike, institucionet rezidenciale publike të kujdesit për fëmijë, qendrat rezidenciale për fëmijë jo-publike.
- Inspektimet për zbatimin e Ligjit 26/2017 “Për Produktet Kozmetike”.
- Inspektime për zbatimin e Ligjit Nr. 9942 datë 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”, i ndryshuar.
- Inspektime për zbatimin e Ligjit Nr. 9636 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar.
- Inspektime për zbatimin e Ligjit Nr. 9518 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”, i ndryshuar.
- Inspektime për zbatimin e Ligjit Nr. 8528 datë 23.09.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji”, i ndryshuar.
- Inspektime për zbatimin e masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

# INSPEKTORATI SHTETËROR SHËNDETËSOR
# RAPORTI VJETOR 2022

## HYRJE

Ky raport hartohet sipas kërkesave të Ligjit Nr. 10433, dt. 16. 06. 2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe Urdhërit Nr. 7, dt. 19. 02. 2015 të Inspektoratit Qendror dhe përmbledh aktivitetin dhe arritjet e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor gjatë vitit 2022.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike, i cili kryhet nga struktura përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.

Misioni i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor është: "Garantimi i respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik".

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor në përmbushje të detyrimeve ligjore, synon arritjen e këtyre objektivave:
- Të rrisë sigurinë e produkteve dhe shërbimeve që ofrohen në fushën e shëndetësisë.
- Të ofrojë transparencë dhe metoda sa më bashkëkohore për kryerjen e inspektimeve nëpërmjet mbështetjes së ofruar nga një staf i përgatitur inspektorësh.
- Të ndërgjegjësojë subjektet e inspektimit për masat që duhen marrë për përmirësimin e aktivitetit të tyre në kuadër të legjislacionit në fuqi në lidhje me sigurinë shëndetësore, duke synuar plotësimin e kushteve që kërkohen të arrihen për integrimin Europian.
- Të mbrojë konsumatorët shqiptarë në mënyrë efektive nga risqet dhe kërcënimet në fushën e shëndeti publik.
- Të krijojë një sistem të brendshëm alarmi të shpejtë për të arritur në një gjurmueshmëri të plotë të të gjitha produkteve dhe mallrave brënda fushës që ai mbulon.
- Të përrmirësojë zbatimin e praktikave inspektuese në bazë të programit e-inspektimi.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor në përmbushje të detyrimeve ligjore, kryen:
- Bashkërendimin dhe koordinimin efikas të veprimtarisë inspektuese në fushat të cilat janë në kompetencë të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.
- Sigurimin dhe unifikimin e praktikave më të mira të inspektimit shëndetësor, në shkallë vendi;
- Informimin e publikut për veprimtarinë e inspektimit;
- Përgatitjen e programit dhe raportit vjetor të inspektimit.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ka objekt të punës së tij:
- Identifikimin e rreziqeve në të gjithë vendin dhe kërcënimet nga aktivitetet e paligjshme.
- Kryerjen e inspektimeve në kohë dhe me saktësi si dhe ato të përbashkëta sipas programit vjetor.
- Zhvillimin e zgjidhjeve inovative për të zbutur rreziqet dhe kërcënimet.
- Dhënien e informacionit në kohë dhe cilësi për vendimmarrësit.
- Vlerësimin e kontrolleve të brendshme dhe përmirësimeve që mbështesin zbatimin e suksesshëm të veprimtarisë së ISHSH.

Struktura e ISHSH është është miratuar me Urdhrin 119, datë 28.07.2022 të Kryeministrit të Shqipërisë "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor".

Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor drejtohet nga Kryeinspektori. Kryeinspektori është titullari i institucionit, i cili, në kuadër të funksioneve dhe detyrave të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor ushtron kompetencat e tij.

ISHSH organizohet në dy nivele: Në nivel qendror dhe atë rajonal, për çdo qark të vendit.

Në ISHSH në nivel rajonal krijohen zyra vendore rajonale, të organizuara në sektorë dhe që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në bazë qarku.

ISHSH qendror drejtohet nga Kryeinspektori Shtetëror Shëndetësor. Kryeinspektori drejton veprimtarinë e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, e përfaqëson atë dhe vepron në emër të tij. Kryeinspektori është përgjegjës për ushtrimin e veprimtarisë së ISHSH, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kryeinspektori është përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e funksionimit si dhe për cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së ISHSH.

ISHSH në nivel qëndror përbëhet nga:

- Kryeinspektor i Republikës
- Koordinator i Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion
- Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit
- Drejtoria e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse




ISHSH rajonale drejtohen nga Kryeinspektorët Rajonalë. Kryeinspektori rajonal përfaqëson degën rajonale në marrëdhënie me të tretët në nivelin e qarkut përkatës dhe është përgjegjës për organizimin e funksionimin si dhe për cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së degës së tij.

Degët rajonale të ISHSH funksionojnë në qarqet Tiranë, Elbasan, Durrës, Fier, Vlorë, Gjirokastër, Korçë, Berat, Lezhë, Kukës, Dibër, Shkodër.

Degët rajonale drejtohen nga Kryeinspektorët Rajonalë dhe përbëhen nga këto sektorë:

- Sektori i Inspektimit Sanitar
- Sektori i Inspektimeve të tjera Shëndetësore
- Sektori i Financës dhe i Shërbimeve të Brendshme

Dega rajonale e ISHSH Tiranë ka në përbërje edhe Sektorin/Njësinë Kufitare të Inspektimit Shëndetësor, e cila kryen aktivitetin e saj pranë Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit "Nënë Tereza".

# INSPEKTORATI SHTETËROR SHËNDETËSOR
# RAPORTI VJETOR 2022

## QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

### QËLLIMI

- Identifikimi i rreziqeve në të gjithë vendin dhe kërcënimet nga aktivitetet e që përbëjnë rrezik për shëndetin publik.
- Kryerjen e inspektimeve në kohë dhe me saktësi, si dhe atyre të përbashkëta sipas programimit vjetor.
- Dhënia e informacionit në kohë dhe cilësi për organet eprore politikëbërëse.
- Vlerësimi i kontrolleve të brendshme dhe përmirësime që mbështesin zbatimin e suksesshëm të veprimtarisë së ISHSH.

### METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur në këtë raport bazohet në programin e inspektimit i cili është instrumenti që përdor inspektorati shtetëror për planifikimin e akteve të inspektimit, me qëllim kontrollin për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit.
Raporti është bazuar në aktet e inspektimit dhe raportet e inspektimit mujor.

# 1. DREJTORIA E KOORDINIMIT DHE MONITORIMIT TË INSPEKTIMIT

## Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit, ISHSH Qendror.

Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit është struktura përgjegjëse për koordinimin, inspektimin dhe raportimin e realizimit të Programit të Inspektimit zyrtar të kryer në të gjithë vendin të përcaktuar në vijim të rregullores. Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit koordinon veprimtarinë e degëve rajonale, për çështje dhe praktika që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punës në zbatimin e programeve të inspektimit në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e shëndetësisë si dhe me procedurat standarte të inspektimit referuar objektivave të ISHSH. Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit ka për qëllim të realizojë detyrat në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, duke përdorur me efikasitet burimet njerëzore.

Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit përbëhet nga:
- Sektori i Inspektimit Sanitar
- Sektori i Inspektimeve të tjera Shëndetësore

Inspektorët e Drejtorisë së Koordinimit dhe Monitorimit të Inspektimit:
1. Ndjekin zbatimin e Ligjeve dhe të akteve nënligjore në fuqi mbi bazën e të cilave është ngritur dhe funksionon veprimtaria e ISHSH-së.
2. Marrin pjesë në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore në bashkëpunim me specialistë të ISHP-së dhe të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
3. Garantojnë transparencën e aktivitetit të institucionit në fushën e inspektimit.
4. Përmbledhja dhe hartimi raporteve periodike në institucionet eprore.
5. Hartimi dhe kontrolli i zbatimit të planeve vjetore dhe mujore.
6. Ndjekin zbatueshmërinë e Marrëveshjeve, Memorandumeve me Urdhrat Profesionalë dhe organizata partnere vendase dhe të huaja.
7. Koordinojnë pjesëmarrjen e stafit në Grupe Pune ndërinstitucionale, task forca të ndryshme.
8. Koordinojnë programet e vlerësimit të punës së punonjësve duke siguruar paanshmëri dhe objektivitet në gjykime.

## Sektori i Inspektimit Sanitar, ISHSH rajonal.

Sektori i Inspektimit Sanitar është struktura përgjegjëse për inspektimin dhe realizimin e programit të inspektimit vjetor të hartuar nga ISHSH Qendror. Sektori bashkëpunon me sektorët e tjerë për çështje dhe praktika që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punës në zbatimin e programeve të inspektimit në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e inspektimit sanitare si dhe me proçedurat standarte të inspektimit referuar objektivave të ISHSH Rajonal. Sektori i Inspektimit Sanitar ka për qëllim të realizojë detyrat në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, duke përdorur me efikasitet burimet njerëzore.

## Sektori i Inspektimeve të Tjera Shëndetësore (ISHSH rajonal)

Sektori i Inspektimeve të tjera shëndetësore është struktura përgjegjëse për inspektimin dhe realizimin e programit të inspektimit vjetor të hartuar nga ISHSH Qendror. Sektori

bashkëpunon me sektorët e tjerë për çështje dhe praktika që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punës në zbatimin e programeve të inspektimit në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e inspektimeve të tjera shëndetësore si dhe me proçedurat standarte të inspektimit referuar objektivave të ISHSH Rajonal, Sektori i Inspektimeve të tjera Shëndetësore ka për qëllim të realizojë detyrat në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, duke përdorur me efikasitet burimet njerëzore.

**Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

Inspektorët e Sektorit të Inspektimit Sanitar dhe Inspektimeve të tjera Shëndetësore:

- Kryejnë inspektime, sipas përcaktimeve në programimin e inspektimit.
- Zbatojnë procedurat dhe hapat e inspektimit sipas Ligjit nr 10 433 datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjeve e akteve të tjera nën ligjore në fushën e shëndetit publik që janë në fuqi.
- Kryejnë detyrat që u ngarkohen konform legjislacionit në fuqi, në kohë dhe me cilësi si dhe duke respektuar me rigorizitet kërkesat dhe parimet kryesore si objektiviteti, korrektësia, konfidencialiteti, profesionalizmi etj.
- Gjatë ushtrimit të detyrës, ruajnë konfidencialitetin e të dhënave dhe japin informacion vetëm në bazë dhe brenda kufijve të ligjit dhe rregullores të institucionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare apo profesionale të subjektit të inspektimit apo personave të tjerë.
- Gjatë ushtrimit të kontrollit, janë të detyruar të zbatojnë të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi si dhe akte të tjera administrative që janë në funksion të veprimtarisë në fushën e inspektimeve.
- Mbajnë lidhje të vazhdueshme me përgjegjësin e sektorit dhe i njofton ata për ecurinë dhe problemet që evidentohen gjatë ushtrimit të inspektimit dhe për masat e ndërhyrjet që kërkohen në proces në varësi të këtyre problemeve.
- I kërkojnë përgjegjësit të sektorit zgjatjen e afatit të programuar për përfundimin e inspektimit, kur e gjykon të nevojshme dhe e argumenton atë me volum më të madh pune nga parashikimi apo për probleme të ndryshme të dala gjatë procesit të inspektimit.
- Bazuar në rezultatet dhe dokumentacionin e inspektimit, hartojnë relacion inspektimi, ku pasqyrohen përfundimet e arritura nga inspektimi.
- Marrin dokumenta për sigurimin e provave dhe fotokopje të vërtetuara me origjinalin të dokumentave për veprimet që kanë lidhje me inspektimin që ushtrohet.
- Në përfundim të të gjithë fazave dhe procedurave të kontrollit të çdo subjekti plotësojnë dosjen e kontrollit në inventarin e së cilës evidentohet dhe administratohet i gjithë dokumentacioni i kontrollit sipas kërkesave të përcaktuara.
- Dorëzojnë tek përgjegjësi i sektorit ose një punonjësi të autorizuar prej tij, dosjen e plotësuar si më sipër dhe me shkresën evidentuese për çdo inspektim të përfunduar.
- Mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore, administrative, sipas rastit, për vërtetësinë dhe saktësinë e rezultateve të punës së tij inspektuese.
- Inspektorët që ngarkohen me shqyrtimin e denoncimeve duhet të marrin cdo informacion dhe dokumentacion të nevojshëm nga përgjegjësi i sektorit dhe për përfundimet e procesit të njoftojnë organet përkatëse dhe subjektin denoncues.
- Marrin masë administrative në rastet e konstatimit të shkejeve ligjore së bashku me inspektorët e tjerë te grupit.
- Përgjigjen para Përgjegjësit të Sektorit për realizimin e detyrave të ngarkuara.
- Mbajnë përgjegjësi për bazën materiale të praktikave inspektuese.

## 1.1 INSPEKTIME, RI-INSPEKTIME DHE MONITORIME.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor kreu 51 785 inspektime, ri-inspektime dhe monitorime në të gjithë territorin e vendit gjatë vitit 2022 si më poshtë vijon:

- 22 992 Inspektime.
- 757 Ri-inspektime.
- 28 036 Monitorime.
- Gjatë vitit 2022 janë pajisur me Akt-Miratim Higjieno-Sanitar 1738 subjekte.

Inspektime, ri-inspektime dhe monitorime, 2022.

| QARKU | INSPEKTIME | RI-INSPEKTIME | MONITORIME |
|---|---|---|---|
| BERAT | 1796 | 23 | 704 |
| DIBER | 1336 | 85 | 2195 |
| DURRES | 2316 | 90 | 3385 |
| ELBASAN | 1247 | 8 | 1272 |
| FIER | 1769 | 26 | 2180 |
| GJIROKASTER | 1204 | 4 | 2138 |
| KORCE | 1509 | 0 | 2349 |
| KUKES | 1341 | 31 | 2806 |
| LEZHE | 1190 | 81 | 1490 |
| SHKODER | 1662 | 73 | 2017 |
| TIRANE | 4853 | 219 | 1028 |
| VLORE | 2755 | 117 | 6221 |
| ISHSH QENDROR | 14 | 0 | 251 |
| **GJITHSEJ** | **22 992** | **757** | **28 036** |

Të gjitha inspektimet dhe ri-inspektimet janë kryer on line nëpërmjet sistemit e-inspection me përjashtim të periudhës së sulmit kibernetik, sulm i cili preku edhe sistemin e-inspection. Inspektimet e kryera jashtë sistemit u kryen me dokumenta standarte dhe listë verifikimi të parashtypura në bazë të udhëzimeve të Inspektoratit Qendror.

Kryerja e inspektimeve nëpërmjet portalit e-inspection si dhe respektimit të rregullores së nxjerrë në zbatim të këtij të fundit, ka si objekt përcaktimin e rregullave për kryerjen e inspektimeve, bazuar në një proçedurë administrative të rregullt Ligjore me qëllim rritjen e efektivitetit, përgjegjshmërisë, transparencës dhe shmangies së korrupsionit në fushën e veprimtarisë së inspektimeve që mbulon ISHSH.

## 1.2 MASA ADMINISTRATIVE

Trupat inspektuese të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor kanë vendosur 1848 masa administrative gjatë vitit 2022 si më poshtë vijon:

- 297 Gjoba në vlerën 68 497 000 Lekë.
- 72 Vendime të Ndërmjetme Për Marrje Mase Urgjente.
- 1 479 Paralajmërime.

Masa Administrative viti 2022

| QARKU | MASA ADMINISTRATIVE/LEKË | VENDIME | PARALAJMËRIME |
|---|---|---|---|
| BERAT | 8 | 2 | 130 |
| DIBER | 6 | 8 | 70 |
| DURRES | 46 | 6 | 2 |
| ELBASAN | 21 | - | 4 |
| FIER | 5 | 11 | 295 |
| GJIROKASTER | 13 | - | 348 |
| KORCE | 11 | - | 1 |
| KUKES | 8 | 8 | 13 |
| LEZHE | 11 | - | 105 |
| SHKODER | 18 | 1 | 3 |
| TIRANE | 132 | 33 | 203 |
| VLORE | 13 | 2 | 305 |
| ISHSH QENDROR | 5 | 1 | - |
| **GJITHSEJ** | **297** | **72** | **1479** |

# 1.3 INSPEKTIMET E KRYERA GJATË VITIT 2022 SIPAS FUSHAVE TË INSPEKTIMIT

## 1.3.1. INSPEKTIME SANITARE

### 1.3.1.1. INSPEKTIME SHËNDETËSORE

**Inspektime në subjektet e kujdesit shëndetësor publik dhe jopublik**

Gjatë vitit 2022, trupat inspektuese të ISHSH kryen 6 442 inspektime dhe ri-inspektime shëndetësore, me qëllim:

- Mbrojtjen e shëndetit të popullatës përmes proçesit inspektues për respektimin e legjislacionit në fuqi në institucionet e kujdesit shëndetësor.
- Rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe standardeve ndaj popullatës në institucionet e kujdesit shëndetësor.

Gjjatë vitit 2022 trupa inspektuese e ISHSH kreu 9 289 monitorime për zbatimin e protokolleve për mbrojtjen dhe parandalimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

**Inspektime për plotësimin e standardeve të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit të institucioneve shëndetësore.**

Inspektimet për plotësimin e standardeve të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit të institucioneve shëndetësore janë kryer bazuar në VKM Nr. 865, datë 24.12.2020, "Për mënyrën e kryerjes së proçesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore", si dhe në Urdhërin Nr. 630, datë 29.12.2017 "Për plotësimin e standardeve të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit të institucioneve shëndetësore" të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Objekt i inspektimi ka qenë:

- Inspektimi i plotësimit të kushteve të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit në përputhje me aktivitetet e licensuara.
- Inspektimi i dokumentacionit.
- Inspektimi i plotësimit të kushteve higjieno-sanitare të ambjenteve ku kryhen vizita dhe ekzaminime.
- Inspektimi i pranisë së pajisjeve dhe aparaturave mjekësore.
- Inspektimi i menaxhimit dhe administrimit të sigurtë të mbetjeve spitalore.

Mangësitë e konstatuara gjatë procesit inspektues kanë qenë si më poshtë vijon:

- Mangësi në dokumentacion, në hartimin e rregulloreve dhe protokolleve për proçedurat përkatëse.
- Mungesa e marrjes së masave të sigurimit të kushteve të duhura për përvetesimin e praktikës së punës dhe edukimin profesional dhe teknik të stafit në lidhje me protokollet dhe rregulloret e brendëshme të funksionimit.
- Mungesa e stafit mjekësor të licensuar në përputhje me shërbimet e deklaruara në licensën përkatëse.

- Mangësi në procedurën e administrimit te mbetjeve spitalore
- Mangësi në krijimin e aksesit për personat me aftesi të kufizuara (mungesa e rampës)

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor gjatë vitit 2022 ka kryer 548 inspektime dhe ri-inspektime për plotësimin e standardeve të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit të institucioneve shëndetësore.

| QARKU | INSPEKTIME | RI-INSPEKTIME | PARALAJMERIME |
|---|---|---|---|
| BERAT | 37 | 0 | |
| DIBER | 38 | 0 | |
| DURRES | 49 | 2 | |
| ELBASAN | 48 | 0 | |
| FIER | 49 | 0 | |
| GJIROKASTER | 35 | 0 | |
| KORCE | 57 | 0 | |
| KUKES | 53 | 1 | |
| LEZHE | 29 | 0 | 8 |
| SHKODER | 31 | 0 | |
| TIRANE | 78 | 0 | |
| VLORE | 36 | 0 | |
| QENDRORI | 5 | 0 | |
| **GJITHSEJ** | **545** | **3** | **8** |

Gjatë vitit 2022 janë kryer inspektime dhe është konstatuar se plotësojnë standartet bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit në përputhje me specialitetet e përcaktuara në licencat përkatëse:

- 3 Spitale Terciare.
- 12 Spitale Rajonale.
- Spitali Memorial, Fier.
- 5 Spitale jo publike.
- 300 Qendra Shëndetësore publike.
- 27 Qendra mjekësore jo publike..

**<u>Inspektime për Kujdesin Shëndetësor Spitalor.</u>**

Gjatë vitit 2022, trupat inspektuese të ISHSH, kryen 108 inspektime dhe ri-inspektime me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës përmes proçesit inspektues të respektimit të legjislacioneve në fuqi për kujdesin shëndetësor spitalor.

- 101 inspektime
- 7 ri-inspektime

Objektet e monitorimit ishin:

- Monitorimi i plotësimit të normave dhe standardeve të shërbimit të kujdesit shëndetësor.
- Monitorimi i shërbimit të urgjencës dhe proçedurat e pranimit.
- Monitorimi i kushteve higjieno sanitare.
- Kontrolli i menaxhimit dhe administrimit të sigurt të mbetjeve spitalore.

Problematika e konstatuar:

- Ka mangësi në dokumentacion, në hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit të spitalit, dhe protokolleve dhe rregulloreve për shërbimet dhe proçedurat përkatëse.
- Në Shërbimin e Urgjencës përcaktimi dhe ndarja e zonave për klasifikimin e urgjencave sipas kodeve përkatëse në disa raste nuk është funksionale. Ka mangësi në plotësimin e standardit infrastrukturor ndërtimor për administrimin e Shërbimit të urgjencës. Recepsioni dhe ambjentet e Triazhimit, plotësojnë pjesërisht standartet higjieno sanitare.
- Në pavjone plotësohen pjesërisht standartet higjieno sanitare dhe në disa nga dhomat e pacientëve, nuk respektohet sipërfaqja/shtrat sipas kritereve të përcaktuara.
- Mangësi në sigurimin e kushteve të duhura për përvetësimin e praktikës së punës dhe edukimin profesional dhe teknik të stafit, në lidhje me protokollet dhe rregulloren e brendëshme të funksionimit të spitalit.
- Ka mangësi në plotësimin e kushteve higjeno sanitare, në infrastrukturë dhe funksionimin në bazë të rregulloreve dhe protokolleve të përcaktuara për spitalet, në të gjitha mjediset, ambjentet dhe nyjet hidrosanitare, në përputhje me protokollet dhe rregulloret përkatëse.
- Shërbimi i pastrimit dhe higjenizimit të pajiset me setet dhe infrastrukturën e nevojshme, e klasifikuar sipas llojit dhe specifikës së shërbimit.
- Në Depot Farmaceutike ka mangësi në plotësimin e standardeve infrastrukturore dhe zbatimin e rregullores për medikamentet të cilave i ka kaluar afati i skadencës.
- Ka mangësi në infrastrukturën dhe funksionimin në bazë të rregulloreve dhe protokolleve të përcaktuara në shërbimet e hotelerisë, kuzhinës dhe lavanderisë.
- Në disa raste nuk kryhet procedura nga komisioni përgjegjës për evidentimin dhe largimin e pajisjeve dhe mobiljeve të nxjerra jashtë përdorimit sipas kritereve të përcaktuara.

| QARKU | INSPEKTIME | RI-INSPEKTIME | GJOBA | VENDIME | PARALAJMERIME |
|---|---|---|---|---|---|
| BERAT | 6 | | | | 3 |
| DIBER | 5 | 1 | | | 1 |
| DURRES | 5 | | | | |
| ELBASAN | 7 | | | | |
| FIER | 10 | | | | 5 |
| GJIROKASTER | 8 | | | | 5 |
| KORCE | 12 | | | | |
| KUKES | 12 | | | | |
| LEZHE | 6 | 3 | | | 1 |
| SHKODER | 11 | 2 | | | 1 |
| TIRANE | 6 | 1 | 3 | 1 | |
| VLORE | 9 | | | | 2 |
| QENDRORI | 4 | | 1 | | |
| **GJITHSEJ** | **101** | **7** | **4** | **1** | **18** |

Gjithashtu u monitorua dhe proçedura e administrimit dhe menaxhimit të integruar të mbetjeve të rrezikshme spitalore ku u konstatua se:

- Nuk kishte një plan për menaxhimin dhe monitorimin nga administrata e spitalit për administrimin e mbetjeve spitalore.

- Nuk bëhej monitorimi i eliminimit të mbetjeve spitalore nga ana e prodhuesit për kompaninë e kontraktuar.
- Mangësi në lidhje me trajnimin e personelit që merret me trajtimin e mbetjeve spitalore.
- Nuk respektohej me korrektësi procedura për ndarjen në burim, etiketimin dhe rregjistrimin e mbetjeve spitalore.
- Grumbullimi i mbetjeve spitalore në pikën provizore kryhej në kundërshtim me kriteret e përcaktuara, në ambiente të papërshtatshme, korridore dhe në tualet në të njëjtën hapësirë ku depozitohen dhe mbetjet urbane dhe setet e pastrimit.
- Ka mangësi në infrastrukturën për transportimin e mbetjeve spitalore nga pika provizore e grumbullimit deri në pikën qendrore të grumbullimit dhe magazinimit.
- Punonjësit e shërbimi të trajtimit të mbetjeve spitalore (hidroklava) nuk ishin të pajisur me veshjet dhe masat mbrojtëse specifike sipas kritereve të përcaktuara për këtë lloj procedure.
- Magazinimi i mbetjeve spitalore në vend grumbullimin e përkohshëm brenda territorit të spitalit kryhej jashtë cdo standarti, në kushte të papërshtatshme dhe në kundërshtim me kriteret e përcaktuara.

Gjatë vitit 2022 janë vendosur masat administrative si më poshtë vijon:
- 4 Masa Administrative në lekë
- 1 Vendim i Ndërmjetëm Për Marrje Mase Urgjente
- 18 Paralajmërime.

Gjithashtu gjatë vitit 2022, në periudhën maj - tetor, u krye monitorimi i 11 spitaleve rajonale si dhe QSUT “Nënë Tereza” dhe Spitalit Universitar të Traumës.

## Inspektime për Kujdesin Shëndetësor Parësor

Gjatë vitit 2022, trupat inspektuese të ISHSH kryen 3 334 inspektime dhe ri-inspektime me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës përmes proçesit inspektues të respektimit të legjislacioneve në fuqi për kujdesit shëndetësor parësor.

- 3 191 inspektime
- 143 ri-inspektime

Gjatë vitit 2022 janë vendosur masat administrative si më poshtë vijon:
- 9 Masa Administrative në lekë
- 8 Vendime të Ndërmjetëm Për Marrje Mase Urgjente
- 646 Paralajmërime.

Mangësitë e konstatuara specifike gjatë procesit inspektues në subjektet e kujdesit shëndetësor parësor jo-publik (klinika/qendra/laboratorë mjekësorë):
- Mungesa e një ambjenti të vecantë për marrjen e gjakut.
- Mungesa e Lejes së Ushtrimit të Profesionit

Mangësitë e konstatuara specifike gjatë procesit inspektues në subjektet e kujdesit shëndetësor parësor publik dhe jo-publik kanë qenë si më poshtë vijon:
- Mangësi e ambjenteve për ofrimin e shërbimit shëndetësor parësor.
- Mungesë e instrumentave mjekësorë.

- Mangësi në procedurën e menaxhimit të mbetjeve spitalore (mungesë kontenitorësh, ndarja e mbetjeve nëpër pavjone, mungesë e vend magazinimit on-site, mungesë kontrate për evadimin e mbetjeve spitalore etj).
- Mungesë e ujit të rrjedhshëm.
- Amortizim i rrjetit të energjisë elektrike.
- Amortizim i ndërtesës fizike (mungesë e lyrjes së ambjenteve, amortizim i nyjeve hidro-sanitare, prani e lagështirës, prani papastërtish, etj.)

Mangësitë në dokumentacionin shëndetësor dhe higjieno-sanitar të konstatuara gjatë proçesit inspektues në subjektet e kujdesit shëndetësor parësor publik dhe jo-publik kanë qenë si më poshtë vijon:

- Mungesa e Akt- Miratimit Higjieno-Sanitar.
- Moskryerja e shërbimit DDD në ambjentet e jashtme e të brendshme.
- Personeli mjekësor i pa pajisur me dokumentacionin shëndetësor të detyrueshëm

| QARKU | INSPEKTIME | RI-INSPEKTIME | GJOBA | VENDIME | PARALAJMERIME |
|---|---|---|---|---|---|
| BERAT | 215 | 5 | 0 | 2 | 93 |
| DIBER | 141 | 20 | 1 | 1 | 18 |
| DURRES | 193 | 23 | 3 | 2 | 0 |
| ELBASAN | 117 | 1 | 3 | 0 | 0 |
| FIER | 269 | 3 | 0 | 0 | 107 |
| GJIROKASTER | 320 | 1 | 0 | 0 | 237 |
| KORCE | 289 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| KUKES | 180 | 12 | 0 | 1 | 0 |
| LEZHE | 276 | 19 | 0 | 0 | 36 |
| SHKODER | 349 | 18 | 0 | 0 | 1 |
| TIRANE | 414 | 20 | 1 | 0 | 14 |
| VLORE | 427 | 21 | 0 | 1 | 140 |
| QENDRORI | 1 | 0 | 1 | 1 | 0 |
| **GJITHSEJ** | **3191** | **143** | **9** | **8** | **646** |

**Inspektime për zbatimin e Ligjit Nr. 9928 "Për shërbimin shëndetësor stomatologjik" të ndryshuar**

Gjatë vitit 2022, trupat inspektuese të ISHSH kryen 1 162 inspektime dhe ri-inspektime në kabinetet dentare publike dhe jo publike dhe laboratorët dentarë publikë dhe jo publikë.

- 1 105 inspektime.
- 57 ri-inspektime

Gjatë vitit 2022 janë vendosur masat administrative si më poshtë vijon:

- 19 Gjoba në lekë.
- 3 Vendime të Ndërmjetëm për Marrje Mase Urgjente
- 48 Paralajmërime.

| QARKU | INSPEKTIME | RI-INSPEKTIME | GJOBA | VENDIME | PARALAJMERIME |
|---|---|---|---|---|---|
| BERAT | 50 | 6 | 3 | 0 | 1 |
| DIBER | 43 | 4 | 0 | 0 | 4 |
| DURRES | 85 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| ELBASAN | 63 | 0 | 6 | 0 | 0 |
| FIER | 108 | 2 | 0 | 0 | 2 |
| GJIROKASTER | 24 | 0 | 1 | 0 | 1 |
| KORCE | 92 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| KUKES | 20 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| LEZHE | 45 | 7 | 0 | 0 | 7 |
| SHKODER | 19 | 11 | 2 | 0 | 0 |
| TIRANE | 390 | 25 | 7 | 3 | 30 |
| VLORE | 86 | 2 | 0 | 0 | 3 |
| **GJITHSEJ** | **1 105** | **57** | **19** | **3** | **48** |

Mangësitë e konstatuara gjatë procesit inspektues kanë qenë si më poshtë vijon:

- Mungesa e kontratave për evadimin e mbetjeve spitalore
- Mungesa në dokumentacionin higjieno sanitare të subjektit: Akt-Miratim higjeno sanitar, certifikata DDD, raport analiza e ujit të pijshëm.

**<u>Inspektime për zbatimin e Ligjit Nr. 10469 “Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues”</u>**

Gjatë vitit 2022, trupat inspektuese të ISHSH kryen 45 inspektime dhe ri-inspektime në subjektet që ushtrojnë veprimtari me burime të rrezatimit jonizues.

- 43 inspektime.
- 2 ri-inspektime

| QARKU | INSPEKTIME | RI-INSPEKTIME |
|---|---|---|
| BERAT | 6 | - |
| DIBER | 1 | - |
| ELBASAN | 1 | - |
| GJIROKASTER | 2 | - |
| KORCE | 5 | - |
| KUKES | 1 | - |
| LEZHE | 1 | **-** |
| SHKODER | 3 | 2 |
| TIRANE | 19 | - |
| VLORE | 4 | - |
| **GJITHSEJ** | **43** | **2** |

Inspektimet për zbatimin e Ligjit Nr. 10469 “Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues”, janë kryer si pjesë e inspektimeve shëndetësore në Qendrat Spitalore Universitare në Tiranë, spitalet rajonale, spitale bashkiake, spitale jo-publike, klinika mjekësore, klinika dhe kabinete dentare etj.

Mangësitë e konstatuara gjatë procesit inspektues kanë qenë si më poshtë vijon:

- Mungesë licence e subjekteve që kryejnë veprimtari me burime të rrezatimit jonizues.

## Inspektime për parandalimin e COVID-19.

Gjatë vitit 2022 trupa inspektuese e ISHSH ka kryer 1 245 inspektime, ri-inspektime dhe 9 289 monitorime për zbatimin e protokolleve për mbrojtjen dhe parandalimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, ISHSH, ishtë institucioni kryesor i ngarkuar me zbatimin e Ligjit 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive" e të gjitha Akteve Normative të Këshillit të Ministrave dhe Urdhrave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në funksion të parandalimit të infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19.

| Inspektime per COVID-19 | Insp. | Ri-insp | Monitorime | Gjoba | Vendime | Paralajmerime |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Institucionet e Sherbimit Shendetesor, spitale, ambulanca, qendra shendetesore. | 80 | 2 | 247 | 6 | 2 | 1 |
| Pika te shitjeve te produkteve ushqimore, markete e supermarkete, dyq. Mishi. | 93 | 7 | 3 218 | 10 | 0 | 5 |
| Furra buke/ pasticeri. | 74 | 0 | 486 | 3 | 0 | 1 |
| Bar-kafe/restorante/ piceri/ fast food. | 163 | 0 | 1 347 | 21 | 1 | 6 |
| Farmaci. | 5 | 0 | 351 | 0 | 0 | 0 |
| Klinika/ laborator dentar. | 1 | 0 | 90 | 0 | 0 | 0 |
| Subjekte argetimi, qendra interneti, playstation, lojra per femije, etj. | 1 | 0 | 6 | 0 | 0 | 0 |
| Biznese; fason/ call center/ fabrika e linja prodhimi e perpunimi, | 115 | 0 | 21 | 3 | 0 | 0 |
| Miniera/ Nxjerrje Nafte | 12 | 1 | 1 | 0 | 0 | 2 |
| Subjekte arsimore | 149 | 13 | 541 | 0 | 26 | 0 |
| Berber/parukeri | 12 | 0 | 116 | 0 | 0 | 0 |
| Hotele | 30 | 0 | 28 | 0 | 0 | 0 |
| Zyra Pagesash (OShEE, UK, Sherbim Postar) | 93 | 0 | 92 | 1 | 0 | 3 |
| Shitje me pakice e produkteve te tjera jo ushqimore | 36 | 0 | 1 506 | 9 | 0 | 3 |
| Subjektet e furnizimit me uje te pijshem | 0 | 0 | 24 | 0 | 0 | 0 |
| Sherbime te ndryshme riparimi(celulare, kompjuter, auto, gomisteri etj..) | 2 | 0 | 82 | 0 | 0 | 0 |
| IEVP | 9 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| MEDIA TV | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Institucione Publike | 317 | 29 | 1 105 | 0 | 2 | 11 |
| Taxi/Mjete Transporti | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Individ | 1 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| Pishinat | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Sipërmarrje të Aktiviteteve Turistike | 0 | 0 | 28 | 0 | 0 | 0 |
| **Gjithsej** | **1 193** | **52** | **9 289** | **54** | **31** | **32** |

## 1.3.1. INSPEKTIME SANITARE

### 1.3.1.2. INSPEKTIME SANITARE

Gjatë vitit 2022, trupat inspektuese të ISHSH kryen 12 033 inspektime dhe ri-inspektime sanitare.

- Inspektime në institucione parashkollore, shkollore, institucione të arsimit të lartë dhe subjekte të akomodimit dhe shërbimit te tyre.
- Inspektime para dhe gjatë sezonit turistik.
- Inspektime në subjekte të furnizimit me ujë të pijshëm.
- Inspektimi i ndërmarrjeve për kujdesin shëndetësor në punë.
- Inspektim në shtëpitë e të moshuarve publike dhe jopublike, institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të kujdesit për fëmijë.
- Inspektimi i Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, IEVP, paraburgimit dhe ambienteve të ndalimit në Drejtoritë dhe Komisariatet e Policisë.

Objekti i inspektimeve ka qenë:

- Krijimi i kushteve optimale të mësimit dhe shlodhjes në institucione arsimore publike dhe jo-publike.
- Sigurimi i cilësisë së ujit të pijshëm me qëllim parandalimin e intoksikacioneve me origjinë hidrike.
- Kontrolli dhe sigurimi i kushteve optimale për një sezon turistik të sigurt dhe të suksesshëm duke siguruar përgjigjen në kohë në raste situatash emergjente.
- Kontrolli i dhënies së shërbimit shëndetësor në ambientet e punës dhe identifikimin e situatave të mundshme të rrezikshme që dëmtojnë shëndetin e punonjësve që janë në kontakt me to, përtej normave të lejuara.
- Garantimin e plotësimit të kushteve higjieno-sanitare dhe pajisjen me dokumentacionin e nevojshëm higjieno sanitar dhe shëndetësor të të gjitha subjekteve, objket inspektimi i ISHSH.

Të gjitha subjektet e inspektuara gjatë periudhës janar – prill 2022, janë inspektuar njëkohësisht dhe për zbatimin e Protokolleve të miratuara për parandalimin e Covid-19.

**Inspektime në institucione parashkollore, shkollore, institucione të arsimit të lartë dhe subjekte të akomodimit dhe shërbimit te tyre.**

Gjatë vitit 2022 u kryen 3 839 inspektime dhe ri-inspektime të subjekteve publike dhe jopublike arsimore parashkollore, shkollore, në instutucionet e arsimit të lartë, si dhe në konviktet dhe mencat e institucioneve të arsimit të mesëm dhe të lartë me qëllim inspektimin e zbatimit të Ligjeve dhe akteve nënligjore në institucionet arsimore për të siguruar optimumin shëndetësor të kushteve të mësimit, jetesës e shlodhjes.

- 3 719 inspektime
- 120 ri-inspektime

Mangësitë e konstatuara gjatë procesit inspektues kanë qenë si më poshtë vijon:

- Mungesa e dokumentacionit të detyrueshëm higjieno sanitar për subjektin dhe për personelin.
- Moskryerja e shërbimit të dezinfektimit (DDD)
- Amortizim i ndërtesave të shkollave.
- Prania e lagështisë në ambjentet e instuticioneve.
- Amortizimi i bazës materiale të shkollave (banka, karrige etj).
- Amortizim i rrjetit elektrik dhe hidraulik.
- Gjendje e rënduar e anekseve hidro-sanitare dhe pajisjeve të tyre.
- Mosfurnizim me ujë të rrjedhshëm, mungesa e ujit të ngrohtë.
- Mangësi në pajisjen e bllokut të gatimit në kopshte.
- Mungesa e ambjenteve të domosdoshëm në çerdhe
- Tualete të papërshtatshme për grup moshën në institucione arsimore parashkollore.

| QARKU | INSPEKTIME | RI-INSPEKTIME | GJOBA | VENDIME | PARALAJMERIME |
|---|---|---|---|---|---|
| BERAT | 212 | 3 | | | 16 |
| DIBER | 149 | 25 | | | 18 |
| DURRES | 465 | 3 | 1 | | |
| ELBASAN | 169 | 2 | 1 | | |
| FIER | 405 | 12 | | | 140 |
| GJIROKASTER | 135 | 0 | | | 83 |
| KORCE | 264 | 0 | | | |
| KUKES | 273 | 3 | 1 | 3 | 5 |
| LEZHE | 201 | 8 | 1 | | 8 |
| SHKODER | 413 | 16 | 2 | | |
| TIRANE | 480 | 44 | 3 | 1 | 21 |
| VLORE | 553 | 4 | | | 68 |
| **GJITHSEJ** | **3719** | **120** | **9** | **4** | **359** |

Gjatë vitit 2022 janë vendosur masa administrative si më poshtë vijon:

- 9 Masa Administrative në lekë
- 4 Vendime të Ndërmjetëm për Mbyllje Provizore.
- 359 Paralajmërime

**<u>Inspektime para dhe gjatë sezonit turistik</u>**

Gjatë vitit 2022 u kryen 3 734 inspektime dhe ri-inspektime në subjekte të sezonit turistik veror me qëllim inspektimin e zbatimit të Ligjeve dhe akteve nënligjore në sektorët shtetërorë, privatë dhe veprimtaritë e ndryshme të ushtruara nga persona fizikë e juridike, vendas e të huaj.

- 3 553 inspektime.
- 181 ri-inspektime.

Gjatë vitit 2022 janë vendosur masat administrative si më poshtë vijon:

- 14 Masa Administrative në lekë
- 6 Vendime të Ndërmjetëm Për Marrje Mase Urgjente

- 189 Paralajmërime.

Problematika në Akomodim dhe Pishina

- Mungesa e dokumentacionit shëndetësor dhe higjieno sanitar.
- Mungesa e rregjistrit të monitorimit të ujit të pijshëm.
- Mungesë e dokumentit të Kryqit të Kuq për dhënien e ndihmës së parë.
- Mungesë e rregjistrit për kontrollin e ujit të basenit
- Rregullorja jo konform legjislacionit
- Analiza uji të basenit me ndotje bakteriale dhe me nivele të ulëta të klorit.

Problematika në subjektet e furnizimit me ujë të pijshëm

- Mos respektimi i zonave të afërta dhe të largëta të mbrojtjes sanitare.
- Moskryerja e analizës periodike për kontrollin e cilësisë së ujit.
- Mungesa e dokumentacionit të detyrueshëm shëndetësor të punonjësve.
- Mungesa e analizës së lëndëve dezinfektante të ujit të pijshëm.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 83 datë 11.05.2022 “Për ngritjen e Task-Forcës Ndërinstitucionale të sezonit turistik veror 2022”, si edhe në kuadër të zbatimit të detyrave në përmbushje të planit të masave për sezonin turistik veror 2022, nga data 20.06.2022 deri me 02.09.2022, janë inspektuar 943 subjekte që ndodhen në vijën bregdetare dhe në Liqenin e Pogradecit për mënyrën se si i eliminojnë ujrat e zeza.

**Inspektime në subjekte të furnizimit me ujë të pijshëm**

Gjatë vitit 2022, janë kryer 1 438 inspektime dhe ri-inspektime në subjekte të furnizimit me ujë të pijshëm.

- 1 414 inspektime
- 24 ri-inspektime

| QARKU | INSPEKTIME | RI-INSPEKTIME | GJOBA | VENDIME | PARALAJMERIME |
|---|---|---|---|---|---|
| BERAT | 92 | 1 | | | 6 |
| DIBER | 47 | 4 | | 5 | |
| DURRES | 112 | 1 | | 1 | |
| ELBASAN | 76 | 0 | | | 1 |
| FIER | 276 | 0 | | | 11 |
| GJIROKASTER | 147 | 0 | | | |
| KORCE | 166 | 0 | | | |
| KUKES | 80 | 4 | | 4 | |
| LEZHE | 38 | 0 | | | 3 |
| SHKODER | 57 | 1 | 1 | | |
| TIRANE | 62 | 5 | | | 3 |
| VLORE | 261 | 8 | | | 8 |
| **GJITHSEJ** | **1414** | **24** | **1** | **10** | **32** |

Mangësitë e konstatuara gjatë procesit inspektues kanë qenë si më poshtë vijon:

- Mungesa e aparatit për dozimin e lëndës dezinfektante, klorinim manual
- Depo të parrethuara dhe të amortizuara me prani të lagështisë.
- Mungesë e rrethimit të zonave të mbrojtjes sanitare.
- Bimësi e rritur dhe papastërti në zonat e mbrojtjes
- Mungesë e raport analizës periodike për kontrollin e cilësisë së ujit.
- Mungesë e raport analizës së lëndës dezinfektante të ujit nga strukturat vendore të kujdesit shëndetësor.
- Mungesa e dokumentacionit të detyrueshëm shëndetësor të punonjësve.
- Mungesë e Akt-Miratimit higjieno sanitar të objekteve të UK.
- Moskryerja e shërbimit të dezinfektimit (DDD)
- Mungesë e regjistrave për dokumentimin e dezinfektimit të depove të ujit të pijshëm.
- Mungesë e rojes 24 orë në subjektet e furnizimit me ujë të pijshëm, si subjekte të rëndësisë së veçantë.
- Mungesë e ambjenteve të veçantë për ruajtjen e dezinfektantëve.

Gjatë inspektimeve ose në bazë të denoncimeve për ndotje të ujit të pijshëm janë vendosur masa administrative si më poshtë vijon:

- 1 Masë Administrative në lekë
- 10 Vendime të Ndërmjetëm Për Marrje Mase Urgjente.
- 32 Paralajmërime.

**<u>Inspektimi i ndërmarrjeve për kujdesin shëndetësor në punë.</u>**

Gjatë vitit 2022 trupat inspektuese kryen 1 227 inspektime dhe ri-inspektime me qëllim mbulimin me shërbim mjekësor, nëpërmjet mjekut të punës, të përshtatshëm për rreziqet që paraqet vendi i punës, duke përfshirë normat, rregullat dhe procedurat për të siguruar kontrollin mjekësor të pranimit në punë dhe ato periodike për punëmarrësin. Garantimin e kujdesit shëndetësor profesional dhe praninë e dokumentacionit shëndetësor në subjekt ku pasqyrohet puna e tij. Kontrollin e kushteve higjieno sanitare në mjediset e punës.

| QARKU | INSPEKTIME | RI-INSPEKTIME | GJOBA | VENDIME | PARALAJMERIME |
|---|---|---|---|---|---|
| BERAT | 46 | 6 | | | 6 |
| DIBER | 80 | 16 | | | 13 |
| DURRES | 253 | 1 | | 2 | |
| ELBASAN | 74 | 3 | 6 | | 2 |
| FIER | 49 | 0 | | | 4 |
| GJIROKASTER | 42 | 3 | | | 6 |
| KORCE | 69 | 0 | | | |
| KUKES | 15 | 4 | | | |
| LEZHE | 21 | 5 | 3 | | 3 |
| SHKODER | 58 | 2 | | | |
| TIRANE | 371 | 37 | 3 | | 50 |
| VLORE | 61 | 11 | | | 11 |
| **GJITHSEJ** | **1139** | **88** | **12** | **2** | **95** |

- 1.393 inspektime
- 88 ri-inspektime

Objekti i inspektimit
Në të gjitha ndërmarjet të cilat klasifikohen sipas aktivitetit dhe numrit të punëmarrësve në grupet A, B C, D.

Mangësitë e konstatuara gjatë procesit inspektues kanë qenë si më poshtë vijon:
- Mungesë e Akt-Miratimit Higjieno-Sanitar.
- Mungesë e kontratës me mjekun e punës
- Punonjës të pa pajisur me dokumentacionin bazë mjekësor.
- Mungesë e pajisjeve të nevojshme në dhomës e mjekut të punës
- Mos plotësimi i saktë i kartelave mjekësore

Gjatë vitit 2022 janë vendosur masat administrative si më poshtë vijon:
- 12 Masa Administrative në lekë
- 2 Vendime të Ndërmjetëm Për Marrje Mase Urgjente
- 95 Paralajmërime.

**Inspektime në shtëpitë e të moshuarve, publike dhe jopublike, institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të kujdesit për fëmijë.**

Gjatë vitit 2022 trupat inspektuese të ISHSH kryen 71 inspektime dhe ri-inspektime në shtëpitë e të moshuarve publike dhe jopublike, institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të kujdesit për fëmijë me qëllim monitorimin e zbatimit të Ligjeve dhe akteve nënligjore për respektimin e kushteve higjieno-sanitare në këto institucione të kujdesit social.

| QARKU | INSPEKTIME | RI-INSPEKTIME | GJOBA | VENDIME | PARALAJMERIME |
|---|---|---|---|---|---|
| BERAT | 0 | 0 | | | |
| DIBER | 3 | 0 | | | |
| DURRES | 4 | 0 | | | |
| ELBASAN | 3 | 0 | | | |
| FIER | 1 | 0 | | | 1 |
| GJIROKASTER | 2 | 0 | | | |
| KORCE | 2 | 0 | | | |
| KUKES | 0 | 0 | | | |
| LEZHE | 1 | 1 | | | 1 |
| SHKODER | 9 | 2 | | | |
| TIRANE | 36 | 3 | 1 | | 1 |
| VLORE | 4 | 0 | | | |
| **GJITHSEJ** | **65** | **6** | **1** | **0** | **3** |

Mangësitë e konstatuara gjatë procesit inspektues kanë qenë si më poshtë vijon:
- Mungesë e Akt-Miratimit Higjieno-Sanitar
- Mungesë e kryerjes së shërbimit të dezinfektimit (DDD)
- Mungesa e dokumentacionit të detyrueshëm shëndetësor të personelit (libreza shëndetësore, KML).

- Amortizim dhe prani të lagështisë në ambientet e subjekteve (lavanderisë, kuzhinës dhe në dhomat e ndenjes).
- Mungesë e ujit të ngrohtë
- Mungesa e mjekut për ofrimin e kujdesit shëndetësor.
- Mungesë e personelit sanitar në institucion.

Gjatë vitit 2022 janë vendosur masat administrative si më poshtë vijon:
- 1 Masë Administrative në lekë
- 3 Paralajmërime

**Inspektimi i Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, IEVP, paraburgimit dhe ambienteve të ndalimit në Drejtoritë dhe Komisariatet e Policisë.**

Gjatë vitit 2022 trupat inspektuese të ISHSH kryen 65 inspektime dhe ri-inspektime në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, IEVP, si dhe ambientet e ndalimit në Drejtoritë dhe Komisariatet e Policisë në Qarqe me qëllim monitorimin e zbatimit të Ligjeve dhe akteve nënligjore për respektimin e kushteve higjieno-sanitare dhe shëndetësore në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe të paraburgimit.

Mangësitë e konstatuara gjatë procesit inspektues kanë qenë si më poshtë vijon:
- Mungesë e Akt-Miratimit Higjieno-Sanitar
- Kushtet jashtë normave higjieno sanitare
- Ka mungesë të bazës materiale.
- Kushte jo të përshtatëshme të nyjeve hidro-sanitare.
- Lagështi në ambjentet ku qëndrojnë të burgosurit.
- Kushte jashtë normave higjieno sanitare të kuzhinës
- Nuk është kryer shërbimi DDD

Gjatë vitit 2022 janë vendosur masat administrative si më poshtë vijon:
- 4 paralajmërime

| QARKU | INSPEKTIME | RI-INSPEKTIME | GJOBA | VENDIME | PARALAJMERIME |
|---|---|---|---|---|---|
| BERAT | 4 | 0 | | | 1 |
| DIBER | 5 | 1 | | | 1 |
| DURRES | 6 | 0 | | | |
| ELBASAN | 5 | 0 | | | |
| FIER | 2 | 0 | | | |
| GJIROKASTER | 4 | 0 | | | 2 |
| KORCE | 2 | 0 | | | |
| KUKES | 5 | 2 | | | |
| LEZHE | 4 | 0 | | | |
| SHKODER | 4 | 0 | | | |
| TIRANE | 16 | 0 | | | |
| VLORE | 5 | 0 | | | |
| **GJITHSEJ** | 62 | 3 | 0 | 0 | 4 |

**Inspektime higjieno sanitare në subjekte të cilat ofrojnë shërbime si parukeri, berber etj.**

Gjatë vitit 2022 u kryen 526 inspektime higjieno sanitare në subjekte të cilat ofrojnë shërbime si parukeri, berber etj.

- 503 inspektime
- 23 ri-inspektime

| QARKU | INSPEKTIME | RI-INSPEKTIME | GJOBA | VENDIME | PARALAJMERIME |
|---|---|---|---|---|---|
| BERAT | 16 | 0 | | | 2 |
| DIBER | 40 | 0 | | | |
| DURRES | 26 | 0 | | | |
| ELBASAN | 1 | 0 | | | |
| FIER | 112 | 1 | 2 | 1 | 2 |
| GJIROKASTER | 1 | 0 | | | |
| KORCE | 60 | 0 | | | |
| KUKES | 11 | 0 | | | |
| LEZHE | 1 | 1 | | | 1 |
| SHKODER | 20 | 0 | | | |
| TIRANE | 209 | 17 | 4 | | 18 |
| VLORE | 6 | 4 | | | 4 |
| **GJITHSEJ** | **503** | **23** | **6** | **1** | **27** |

Mangësitë e konstatuara gjatë procesit inspektues kanë qenë si më poshtë vijon:

- Mungesë e dokumentacionit Higjieno-Sanitar dhe shëndetësor.
- Personel i pa kualifikuar për të kryer ndërhyrje estetike.
- Kushtet jashtë normave higjieno sanitare

Gjatë vitit 2022 janë vendosur masa administrative si më poshtë vijon:

- 6 Masa Administrative në lekë.
- 1 Vendim i Ndërmjetëm Për Marrje Mase Urgjente
- 27 Paralajmërime.

**Inspektime për pajisjen me Akt-Miratim Higjieno Sanitar**

Me miratimin e Ligjit Nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, ISHSH, ofron lëshimin e Akt Miratimit Higjieno-Sanitar tërësisht on line nëpërmjet Platformës e-Albania.

Ky proçes filloi me 1 maj 2022 dhe deri me datë 31 dhjetor 2022, nëpërmjet Platformës e-Albania ishin kryer 1 729 aplikime.

| QARKU | INSPEKTIME PER AKT MIRATIME HIGJIENO SANITARE |
|---|---|
| BERAT | 23 |
| DIBER | 17 |
| DURRES | 219 |
| ELBASAN | 39 |
| FIER | 54 |
| GJIROKASTER | 12 |
| KORCE | 63 |
| KUKES | 21 |
| LEZHE | 32 |
| SHKODER | 17 |
| TIRANE | 564 |
| VLORE | 72 |
| **GJITHSEJ** | **1 133** |

Gjatë vitit 2022 trupat inspektuese të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor kanë pajisur me Akt-Miratim Higjieno-Sanitar 1 738 subjekte në të gjithë vendin.

| QARKU | AKT MIRATIME HIGJIENO SANITARE |
|---|---|
| BERAT | 45 |
| DIBER | 47 |
| DURRES | 204 |
| ELBASAN | 73 |
| FIER | 77 |
| GJIROKASTER | 55 |
| KORCE | 77 |
| KUKES | 27 |
| LEZHE | 78 |
| SHKODER | 59 |
| TIRANE | 814 |
| VLORE | 182 |
| **GJITHSEJ** | **1738** |

## 1.3.2. INSPEKTIME TË TJERA SHËNDETËSORE

Gjatë vitit 2022, trupat inspektuese të ISHSH kryen 5274 inspektime, ri-inspektime dhe 18 747 monitorime për zbatimin e Ligjeve të tjera, pjesë e përgjegjësive të ISHSH:

- Inspektime për zbatimin e Ligjit Nr. 26/2017 "Për produktet kozmetike".
- Inspektime për zbatimin e Ligjit Nr. 8528 "Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji" të ndryshuar.
- Inspektime për zbatimin e Ligjit Nr. 9942 datë 26.06.2008 "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut" të ndryshuar.
- Inspektime për zbatimin e Ligjit Nr. 9636 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" të ndryshuar.
- Inspektimet e kryera për zbatimin e Ligjit Nr. 9518, datë 18.4.2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe atyre me sheqer të shtuar" të ndryshuar.

Inspektimet kanë pasur qëllim:

- Mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe garantimin e cilësisë së produkteve kozmetike të bëra të disponueshme në treg, duke përcaktuar kërkesat që duhet të përmbushë çdo produkt kozmetik.
- Nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji, si dhe të rregullojë tregtimin e zëvendësuesve të qumështit të gjirit për të ushqyerit e shëndetshëm të fëmijëve.
- Parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut, nëpërmjet jodizimit të përgjithshëm të kripës, të destinuar për konsum njerëzor e shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore.
- Mbrojtjen e shëndetit publik nga përdorimi i produkteve të duhanit dhe ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit të tyre.
- Parandalimin e pasojave shëndetësore nga konsumi i alkoolit, nëpërmjet përdorimit të pijeve alkoolike nga të miturit

**<u>Inspektime për zbatimin e Ligjit Nr. 26/2017 "Për produktet kozmetike".</u>**

Gjatë vitit 2022 janë kryer:

- 98 inspektime me qëllim vetëm zbatueshmërinë e Ligjit Nr. 26/2017 "Për produktet kozmetike".
- 1125 inspektime në subjekte subjekteve të tregtimi të barnave, farmaci, së bashku me inspektimet për zbatueshmërinë e Ligjit Nr. 8528 "Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji" të ndryshuar
- 1291 inspektime në subjekte të shitjes me shumicë dhe pakicë së bashku me inspektimet për zbatueshmërinë e Ligjit Nr. 9942 datë 26.06.2008 "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut" të ndryshuar; Ligjit Nr. 8528 "Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji" të ndryshuar; Ligjit Nr. 9636 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" të ndryshuar; Ligjit Nr. 9518, datë 18.4.2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe atyre me sheqer të shtuar" të ndryshuar.

<u>Objekti i inspektimit:</u>

- Subjektet tregtuese të produkteve kozmetike.
- Subjektet prodhuese, (çdo person fizik ose juridik i rregjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, i cili prodhon një produkt kozmetik ose ka një produkt të tillë të disenjuar ose të prodhuar dhe tregton këtë produkt kozmetik sipas emrit ose markës së tij të regjistruar).
- Subjektet mjekësore (subjekte të licencuara sipas legjislacionit në fuqi për licencimin për ofrimin e shërbimeve mjekësore, pjesë e te cilave është dhe përdorimi i produkteve kozmetike).
- Subjektet mjekësore të specializuara.

Mangësitë e konstatuara gjatë procesit inspektues kanë qenë si më poshtë vijon:

- Mos raportimi pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bazuar në Ligj Nr. 26/2017 "Për Produktet Kozmetike".
- Mungesë etiketimi korrekt në gjuhën shqipe

Gjatë vitit 2022 janë vendosur masa administrative si më poshtë vijon:

- 3 Masa Administrative në lekë.
- 

| QARKU | INSPEKTIME | RI-INSPEKTIME | GJOBA | VENDIME | PARALAJMERIME |
|---|---|---|---|---|---|
| FIER | 22 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| TIRANA | 75 | 0 | 3 | 0 | 0 |
| GJIROKASTER | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **GJITHSEJ** | 95 | 0 | 3 | 0 | 0 |

**<u>Inspektime për zbatimin e Ligjit Nr. 8528 "Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji" të ndryshuar.</u>**

Gjatë vitit 2022 janë kryer:

- 16 inspektime me qëllim vetëm zbatueshmërinë e Ligjit Nr. 8528 "Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji" të ndryshuar.
- 1027 inspektime në subjekte subjekteve të tregtimi të barnave, farmaci, së bashku me inspektimet për zbatueshmërinë e Ligjit Nr. 26/2017 "Për produktet kozmetike".
- 1291 inspektime në subjekte të shitjes me shumicë dhe pakicë së bashku me inspektimet për zbatueshmërinë e Ligjit Nr. 26/2017 "Për produktet kozmetike"; Ligjit Nr. 9942 datë 26.06.2008 "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut" të ndryshuar; Ligjit Nr. 9636 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" të ndryshuar; Ligjit Nr. 9518, datë 18.4.2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe atyre me sheqer të shtuar" të ndryshuar.

**<u>Inspektime për zbatimin e Ligjit Nr. 9942 datë 26.06.2008 "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut" të ndryshuar.</u>**

Gjatë vitit 2022 janë kryer:

- 179 inspektime me qëllim vetëm zbatueshmërinë e Ligjit Nr. 9942 datë 26.06.2008 "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut" të ndryshuar.
- 1027 inspektime në subjekte të shitjes me shumicë dhe pakicë së bashku me inspektimet për zbatueshmërinë e Ligjit Nr. 26/2017 "Për produktet kozmetike"; Ligjit Nr. 9942 datë 26.06.2008 "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut" të ndryshuar; Ligjit Nr. 9636 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" të ndryshuar; Ligjit Nr. 9518, datë 18.4.2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe atyre me sheqer të shtuar" të ndryshuar.

Mangësitë e konstatuara gjatë procesit inspektues kanë qenë si më poshtë vijon:
- Mungesë e raport-analizës së kripës së joduar.
- Mungesë e etiketimit në gjuhën shqipe të ambalazhit të kripës.

Gjatë vitit 2022 janë vendosur masa administrative si më poshtë vijon:
- 2 Masa Administrative në lekë.
- 27 Paralajmërime
- 2 Vendime të Ndërmjetme Për Marrje Mase Urgjente

**<u>Inspektime për zbatimin e Ligjit Nr. 9636 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" të ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9518, datë 18.4.2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe atyre me sheqer të shtuar" të ndryshuar.</u>**

Gjatë vitit 2022 janë kryer:

- *<u>Duhanpirja/konsumi alkoolit nën 18 vjeç</u>* - 2663 inspektime me qëllim vetëm zbatueshmërinë e Ligjit Nr. 9636 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" të ndryshuar, duhanpirje dhe Ligjit Nr. 9518, datë 18.4.2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe atyre me sheqer të shtuar" të ndryshuar, konsumi nën moshë.

- *<u>Tregtimi</u>* - 1291 inspektime në subjekte të shitjes me shumicë dhe pakicë së bashku me inspektimet për zbatueshmërinë e Ligjit Nr. 26/2017 "Për produktet kozmetike"; Ligjit Nr. 9942 datë 26.06.2008 "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut" të ndryshuar;

ISHSH ka kryer gjithsej 3954 inspektime dhe 18 747 monitorime për zbatimin e Ligjit Nr. 9636 dhe Ligjit Nr. 9518, datë 18.4.2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe atyre me sheqer të shtuar" të ndryshuar dhe ka vendosur 150 masa administrative në lekë dhe 1 paralajmërim gjatë vitit 2022.

Në Progres Raportin e Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2022 vlerësimi në lidhje me zbatimin e Ligjit në fjalë është: *"Në lidhje me kontrollin e duhanit, Ligji për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, i cili është i projektuar për tu përafruar me acquis të BE - së, është duke u zbatuar...."*.

Gjatë vitit 2022 janë vendosur masa administrative si më poshtë vijon:

- 150 gjoba në lekë
- 1 paralajmërim.

| QARKU | GJOBA | PARALAJMERIME |
|---|---|---|
| BERAT | 3 | |
| DIBER | 4 | |
| DURRES | 28 | |
| ELBASAN | 2 | |
| FIER | 2 | |
| GJIROKASTER | 6 | |
| KORCE | 5 | 1 |
| KUKES | 4 | |
| LEZHE | 4 | |
| SHKODER | 5 | |
| TIRANE | 80 | |
| VLORE | 7 | |
| QENDRORI | 0 | |
| **GJITHSEJ** | **150** | **1** |

# 2. DREJTORIA E FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

2.1. Sektori i Financës
2.2. Sektori i Shërbimeve të Brendshme
2.3. Sektori Juridik

## 2.1. Sektori i Financës

Ky sektor ka për qëllim të menaxhojë sistemin buxhetor të ISHSH. Gjatë vitit 2022, Sektori i Financës ka realizuar:

- Hartimin e Projekt Buxhetit për vitin 2022-2023 bazuar në Ligjin 9936 dt. 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" dhe Udhëzimin e Ministrisë Financave Nr.7 datë 28.02.2018 "Për proçedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm".
- Realizimin e shpenzimeve për Pagat (llogaria 600), Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (llogaria 601), shpenzimeve operative (llogaria 602) si dhe shpenzimeve për transferta për buxhetet familjare dhe individët (llogaria 606) për vitin 2022, të përllogaritura në përputhje me VKM Nr.187 datë 08.03.2017.

Në vijim janë paraqitur për ISHSH Qendror dhe Degët rajonale, plani vjetor dhe shpenzimet faktike të ndara sipas klasave të llogarive të shpenzimeve.

| Nr | KODI. INST | INSTITUCIONI | 600 | | 601 | | 602 | | 606 | | Total | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | PLAN VJETOR | FAKT | PLAN VJETOR | FAKT | PLAN VJETOR | FAKT | PLAN VJETOR | FAKT | PLAN VJETOR | FAKT |
| 1 | 1013106 | ISHSH Qendror | 21,275,000 | 21,212,286 | 3,687,000 | 3,530,411 | 38,850,000 | 38,287,024 | 370,000 | 356,000 | 64,182,000 | 63,385,721 |
| 2 | 1013107 | ISHSH Tirane | 44,097,000 | 43,606,726 | 7,448,000 | 7,272,966 | 2,700,000 | 2,688,439 | 844,677 | 844,678 | 55,089,677 | 54,412,809 |
| 3 | 1013111 | ISHSH Berat | 13,573,000 | 13,349,410 | 2,268,000 | 2,229,640 | 1,600,000 | 1,588,860 | 465,000 | 463,120 | 17,906,000 | 17,631,030 |
| 4 | 1013110 | ISHSH Diber | 12,046,000 | 11,633,877 | 2,069,000 | 1,901,533 | 3,000,000 | 2,996,796 | 495,000 | 491,292 | 17,610,000 | 17,023,498 |
| 5 | 1013108 | ISHSH Durres | 20,004,000 | 19,542,433 | 3,312,000 | 3,249,804 | 1,930,000 | 1,440,890 | 445,000 | 440,923 | 25,691,000 | 24,674,050 |
| 6 | 1013109 | ISHSH Elbasan | 14,951,000 | 14,761,244 | 2,538,000 | 2,465,133 | 1,680,000 | 1,090,026 | 355,000 | 352,538 | 19,524,000 | 18,668,941 |
| 7 | 1013112 | ISHSH Fier | 19,267,000 | 18,640,190 | 3,161,000 | 3,111,950 | 1,400,000 | 623,930 | 460,000 | 456,470 | 24,288,000 | 22,832,540 |
| 8 | 1013114 | ISHSH Gjirokaster | 14,927,000 | 14,084,557 | 2,420,000 | 2,274,788 | 2,940,000 | 2,939,018 | 365,000 | 356,240 | 20,652,000 | 19,654,603 |
| 9 | 1013115 | ISHSH Korce | 17,913,000 | 17,388,917 | 3,035,000 | 2,954,532 | 1,800,000 | 1,587,458 | 450,000 | 449,213 | 23,198,000 | 22,380,120 |
| 10 | 1013113 | ISHSH Kukes | 15,193,000 | 14,115,815 | 2,583,000 | 2,328,710 | 3,300,000 | 3,292,328 | 465,000 | 464,272 | 21,541,000 | 20,201,125 |
| 11 | 1013116 | ISHSH Lezhe | 14,762,000 | 14,118,139 | 2,479,000 | 2,357,744 | 1,260,000 | 1,036,962 | 345,000 | 344,972 | 18,846,000 | 17,857,817 |
| 12 | 1013117 | ISHSH Shkoder | 17,661,000 | 17,197,039 | 2,968,000 | 2,881,006 | 1,700,000 | 1,674,785 | 410,000 | 410,000 | 22,739,000 | 22,162,830 |
| 13 | 1013118 | ISHSH Vlore | 21,932,000 | 21,613,093 | 3,655,000 | 3,609,385 | 2,360,000 | 2,282,461 | 680,000 | 678,203 | 28,627,000 | 28,183,142 |
| | | **GJITHSEJ** | **247,601,000** | **241,263,726** | **41,623,000** | **40,167,602** | **64,520,000** | **61,528,977** | **6,149,677** | **6,107,921** | **359,893,677** | **349,068,226** |

| ZERI I BUXHETIT | PLAN | FAKT | REALIZIMI |
|---|---|---|---|
| PAGA (600) | 247,601,000 | 241,263,726 | 97.4 % |
| SIG.SHOQ. DHE SHENDETESORE (601) | 41,623,000 | 40,167,602 | 96.5 % |
| SHPENZIME OPERATIVE. (602) | 64,520,000 | 61,528,977 | 95.4 % |
| SHPENZIME PËR SITUATA TË VESHTIRA DHE FATKEQESI (606) | 6,149,677 | 6,107,921 | 99.3 % |
| **GJITHSEJ** | **359,893,677** | **349,068,226** | **97 %** |

- Plotësimin e pasqyrave të numrit të punonjësve sipas strukturave të miratuara për Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor sipas formatit të 2PU,7 PU, 9 PU.
- Parashikimin e shpenzimeve për mallra e shërbime duke patur parasysh kërkesat në rritje, ku janë të parashikuara: Shpenzime për makina me qira, shpenzime për energji elektrike dhe ujë, shpenzime për pjesë këmbimi dhe siguracion automjete, shpenzime për karburant, shpenzime kancelarie, shtypshkrime si dhe shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve elektronike.
- Pasqyrimin e të ardhurave dytësore sipas llojeve të arkëtimit dhe përdorimit të tyre në bazë të legjislacionit në fuqi.

| KLASIFIKIMI BUXHETOR | TE ARDHURA (LEKË) | REALIZIMI |
|---|---|---|
| AKT MIRATIME HIGJIENO SANITARE (7110199) | 8,898,015 | 27% |
| MASA ADMINISTRATIVE (7115499) | 23,826,666 | 73% |
| **GJITHSEJ** | **32,724,681** | **100%** |

- Inventarizimin e pasurive dhe inventarit ekonomik.
- Përcaktimin e automjeteve në funksion të veprimtarisë e sektorit të inspektimit dhe monitorimit.
- Realizimin e procedurave të prokurimit publik gjatë vitit kalendarik 2022, në bazë të Ligjit Nr. 162/2020, "Për prokurimin publik".
- Hartimin dhe depozitimin e llogarisë vjetore të vitit 2022, bazuar në aktet Ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Publikimin e Pasqyrës Finanaciare Vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave nga masat administrative.
- Përgatitjen e Bilancit të vitit paraardhës dhe pasqyrimin në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ).

<u>Detyra në ndjekje për vitin 2023:</u>

- Evidentimi, kontrolli dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas planit vjetor.
- Përpunimi i dokumentacionit dhe rregjistrimi sistematik në kontabilitet dhe në sistemin online AFMIS.
- Kryerja e rakordimeve për mjetet kryesore, inventarët dhe magazinat sipas legjislacionit në fuqi.

## 2.2. Sektori i Shërbimeve të Brendshme

Sektori i Shërbimeve të Brendshme synon zbatimin e kuadrit Ligjor që lidhet me menaxhimin e burimeve njerëzore të ISHSH-së për të siguruar mbarëvajtjen e aktivitetit të tij në përputhje me Ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse, si edhe administron procedurat lidhur me arkivimin dhe protokollimin e dokumentacionit pranë këtij institucioni.

Gjatë vitit 2022:

- Janë punësuar 37 punonjës, konform strukturës së ISHSH, si dhe në bazë të nevojave të ISHSH-së në nivel qendror dhe degëve rajonale.
    - Për punësimin e punonjësve është ndjekur proçedura e rregullt e punësimit që nis me shpalljen e vendit vakant, aplikimet, komisionin e vlerësimit për përzgjedhjen e kandidatit, propozimi i kandidaturave për Kryeinspektorin dhe zbardhja e Urdhrit të Emërimit.
    - Është mbledhur dokumentacioni i duhur për të plotësuar dosjen e punonjësit sipas kritereve të punësimit.
    - Sipas urdhrit të Kryeministrit Nr. 119 Prot, datë 28.07.2022 për miratimin e Strukturës dhe Organikës së ISHSH u përcaktua dhe skema e strukturës për institucionin.
- Burimet Njerëzore kanë administruar dosjet e punonjësve me dokumentacionin përkatës që duhet të ketë dosja e nëpunësit, si dhe i ka pasuruar ato me dokumentet shtesë të prodhuara për çdo punonjës.
- Për t'u njohur me detyrat dhe punën, inspektorët e rinj janë trajnuar nga ana e strukturave përgjegjëse të ISHSH Qendror si dhe nga Inspektorati Qendror ku është dërguar dokumentacioni i kërkuar, (urdhri i emërimit, ID, foto, Nr. i kontaktit për inspektorët e rinj), për të vazhduar më tej me logimin e inspektorëve, si dhe me trajnimin dhe testimin fillestar nga ana e tyre si dhe çdo dokumentacion i kërkuar prej tyre (lirimet nga detyra të inspektorëve etj).
- Janë ndjekur të gjitha problematikat që kanë të bëjnë me Burimet Njerëzore, të cilat janë raportuar te titullari dhe janë administruar dokumentet përkatëse të sjella prej tyre.
  Me urdhër të Kryeinspektorit janë ngritur komisionet përkatëse për të ndjekur problemet e krijuara si dhe për zgjidhjen e tyre. Në këtë kuadër janë mbajtur procesverbalet mbi problematikat përkatëse.
- Janë administruar perfomancat e punës për punonjësit në ISHSH Qëndror dhe degët rajonale.
- Janë marrë 55 masa disiplinore gjatë këtij viti, si pasojë e shkeljeve të akteve Ligjore dhe nënligjore si dhe akteve të tjera që rregullojnë funksionimin e institucionit.

### 2.3. Sektori Juridik

Sektori juridik synon zbatimin dhe sqarimin juridik të kuadrit ligjor që lidhet me fushën objekt inspektimi të ISHSH për të siguruar mbarëvajtjen e aktivitetit të ISHSH në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse.

Gjatë vitit 2022 Sektori Juridik dhe i Hartimit të Procedurave të Inspektimit (ISHSH qendror) ka kryer detyrat e mëposhtme:

- Ka hartuar projekt rregulloret dhe urdhërat e nxjerra nga Kryeinspektori në bashkëpunim me sektorët përkatës.
- Ka dhënë mbështetje ligjore për sektorët e tjerë të ISHSH qendror dhe për degët e ISHSH në nivel rajonal.
- Ka përfaqësuar institucionin në proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit për çështje të ndryshme ku ISHSH thirret si palë apo inicion vetë një proces gjyqësor sipas tabelës bashkangjitur;
- Në zbatim të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurim publik" të ndryshuar dhe të VKM-ve të nxjerra në zbatim të këtij ligji, ka ndjekur dhe zbatuar të gjitha proçedurat e

prokurimeve publike për plotësimin e nevojave me mallra, shërbime e punë të ISHSH në nivel qëndror dhe rajonal.

- Ka mbështetur proçesin e përgatitjes dhe menaxhimit të buxhetit të ISHSH si dhe administratimin e prokurimeve publike të nevojave të ISHSH në nivel qëndror dhe rajonal.
- Me autorizim të Kryeinspektorit ka kërkuar nga organet shtetërore ose personat juridikë informacione, njoftime dhe dokumenta per nevoja te institucionit.
- Sektori Juridik ka shërbyer si pikë kontakti për të gjithë Sektorët e ISHSH në nivel rajonal.
- Përveç detyrave dhe përgjegjësive të mësipërme, ka kryer dhe detyra të tjera, të ngarkuara nga Kryeinspektorigjate gjithe vitit 2022.
- Sektorit Juridik dhe i Hartimit te Procedurave te Inspektimit ka raportuar për ecurinë e punëve brenda sektorit pranë Kryeinspektorit të ISHSH.
- Ka organizuar pranë ISHSH-së në nivel qendror Komisionin e Ankimit me të gjitha dosjet me dokumentacion përkatës për çdo subjekt ankimues.
- Ka ndjekur me rigorozitet ekzekutimin e masave administrative në bashkëpunim me Përmbaruesit dhe Sektorin e Financës deri në ekzektimin e plotë të tyre.
- Ka marrë pjesë në hartimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor.
- Ka marrë pjesë në hartimin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor të Degëve Rajonale.
- Ka marrë pjesë në hartimin e përshkrimeve të punës për punonjësit e ISHSH Qendror dhe Degë Rajonale.

**Tabela permbledhese e vitit 2022 per 12 Deget Rajonale te Republikes se Shqiperise**

Masat Administrative me vlere monetare te marra sipas Degeve Rajonale ne 2022 dhe ecuria e tyre,

| Nr. | Deget Rajonale | Numri i Masave Administrative me gjobe | Shuma totale te gjithe masave | Procese Gjyqesore Total | Procese Gjyqesore Humbur | Procese Gjyqesore Fituar | Procese gjyqesore ne Procedure | Kerkesa Leshim Urdher Ekzekutimi Derguar nga Qarku ne Gjykate | Vendime Leshim Urdher ekzekutimi dale nga Gjykata | Ne procedure kerkesa per Leshim Urdher Ekzekutimi ne Gjykate | Procese Gjyqesore Apeli Adm. | Pagesa vullnetare | Pagesa vullnetare Shuma total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Tirane | 134 | 37,220,000 | 69 | 24 | 30 | 15 | 60 | 34 | 26 | 1 | 13 | 2,230,000 |
| 2 | Durres | 46 | 10,020,000 | 25 | 4 | 6 | 15 | 20 | 26 | 29 | 2 | 4 | 260,000 |
| 3 | Fier | 5 | 1,700,000 | 4 | 0 | 0 | 4 | 5 | 5 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4 | Vlore | 13 | 3,200,000 | 8 | 2 | 4 | 2 | 9 | 7 | 2 | 0 | 1 | 300,000 |
| 5 | Gjirokaster | 13 | 2,450,000 | 8 | 4 | 1 | 3 | 4 | 0 | 4 | 1 | 2 | 218,000 |
| 6 | Lezhe | 11 | 2,050,000 | 5 | 1 | 3 | 1 | 8 | 5 | 3 | 0 | 2 | 162,600 |
| 7 | Shkoder | 18 | 27,600 | 5 | 2 | 1 | 2 | 9 | 4 | 5 | 0 | 6 | 430,000 |
| 8 | Kukes | 8 | 970,000 | 3 | 0 | 2 | 1 | 5 | 4 | 2 | 0 | 2 | 60,000 |
| 9 | Berat | 8 | 1,012,000 | 5 | 1 | 2 | 3 | 5 | 3 | 2 | 8 | 3 | 110,000 |
| 10 | Elbasan | 19 | 1,400,000 | 15 | 2 | 3 | 8 | 6 | 7 | 8 | 2 | 10 | 299,000 |
| 11 | Korce | 14 | 2,215,000 | 3 | 2 | 1 | 2 | 14 | 7 | 7 | 2 | 4 | 610,000 |
| 12 | Diber | 6 | 1,900,000 | 2 | 0 | 1 | 1 | 6 | 4 | 2 | 0 | 2 | 400,000 |
| 13 | ISHSH | 5 | 1,700,000 | 10 | 1 | 1 | 8 | 2 | 2 | 0 | 2 | 1 | 100,000 |
| ## | Total Masa | 300 | 65,864,600 | 162 | 43 | 55 | 65 | 153 | 108 | 90 | 18 | 50 | **5,179,600** |

- 300 Masa Administrative të vendosura në vitin 2022.
- 162 Procese Gjyqësore të Zhvilluar gjatë vitit 2022.
- 55 Procese Gjyqësore të fituar.
- 43 Procese Gjyqësore të humbur.
- 65 Procese Gjyqësore në procedurë.
- 18 Procese Gjyqësore në procedurë Apeli Administrativ.

Ka organizuar pranë ISHSH qendror 7 (shtatë) Komisione të Ankimit, si dhe ka përgatitur dosjet me dokumentacion përkatës për çdo subjekt ankimues:

- Janë shqyrtuar 175 Masa Administrative.
- Janë lënë në fuqi 165 Masa Administrative
- Janë pranuar 10 Ankime Administrative

- 11 Masa Administrative me Vendim Urdhër Ekzekutimi janë dërguar nga ISHSH.
- 40 Masa të Ekzekutuara me Vlerë 32,724,681 Lekë.
- 71 Masa Administrative me Vendim Lëshim Urdhër Ekzekutimi në procedurë.
- 50 Pagesa vullnetare në vlerë 5,179,600Lekë.
- 68 Masa gjithsej të Ekzekutuara me vlerë 32,724,681 Lekë.

***Tabela permbledhese e vitit 2022 , 12 Deget Rajonale te Republikes se Shqiperise***
***Masat Administrative te vendosura ne vitet 2015/2016/2017/2018/2019/2020/2021/2022 te ardhura prane ISHSH Qendror ne vitin 2022 me Vendim Leshim Urdher Ekzekutimi***

| Nr. | Deget Rajonale | Masa Administrative /Vite | | | | | | | | Vendime Leshim uerdher Ekzekutimi Masa Total | Shuma totale per cdo mase | Masat e ekzektuara /kamatvonesat vite te # ne 2022 | Vendime Pushuar me Vendim Gjykate | Vendime Pushuar / Anulluar Komisioni i Ankimit | Ne procedure ekzekutimi 2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2022 | 2021 | 2020 | 2019 | 2018 | 2017 | 2016 | 2015 | | | | | | |
| 1 | Tirane | 10 | 23 | | | | 1 | | | 34 | 5,660,000 | 12 | 0 | 0 | 22 |
| 2 | Durres | 8 | 18 | | | | | | | 26 | 5,580,000 | 16 | 0 | 0 | 10 |
| 3 | Fier | 1 | 1 | 1 | 1 | | | 1 | | 5 | 1,900,000 | 1 | 0 | 0 | 4 |
| 4 | Vlore | 7 | 1 | 1 | | | | | | 9 | 1,950,000 | 3 | 0 | 0 | 6 |
| 5 | Gjirokaster | 0 | | | | | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 6 | Lezhe | | | | 5 | | 1 | | | 6 | 1,130,000 | 3 | 0 | 0 | 3 |
| 7 | Shkoder | 1 | | 2 | 1 | | | | | 4 | 670,000 | 1 | 0 | 0 | 3 |
| 8 | Kukes | 3 | | 1 | | | | | | 4 | 510,000 | 0 | 0 | 0 | 4 |
| 9 | Berat | 3 | | | | | | | | 3 | 502,000 | 1 | 0 | 0 | 2 |
| 10 | Elbasan | 1 | | 2 | 4 | | | | | 7 | 1,140,000 | 2 | 0 | 0 | 5 |
| 11 | Korce | 4 | 2 | 1 | | | | | | 7 | 900,000 | 0 | 0 | 0 | 7 |
| 12 | Diber | 2 | 2 | | | | | | | 4 | 810,000 | 0 | 0 | 0 | 4 |
| 13 | ISHSH Qendror | 1 | 1 | | | | | | | 2 | 600,000 | 1 | 0 | 0 | 1 |
| ** | Total Masa | | | | | | | | | **111** | ***Shuma totale per cdo mase*** | ***Shuma e arketuar ne Buxhetin e Shtetit*** **/Tabela bashkengjitur** | | | |

# 3. ARRITJET E INSPEKTORATIT SHTETËROR

Puna dhe aktiviteti i ISHSH gjatë vitit 2022 janë kryer bazuar në përvojën më të mirë të institucionit tonë në vite dhe duke pasur në synim funksionimin e një institucioni që i përgjigjet kërkesave për mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe është në shërbim të tyre. Përveç detyrave funksionale, trupa inspektuese e ISHSH ka kryer kontrolle të vazhdueshme për zbatimin e protokolleve të masave të veçanta për parandalimin dhe luftimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

1. Evidentimi i kushteve higjieno-sanitare dhe zbatueshmëria e rregulloreve të MSHMS në funksion të evidentimit të plotësimit të standarteve bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit në shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor publik.
2. Evidentimi i kushteve higjieno-sanitare dhe zbatueshmëria e rregulloreve të MSHMS në funksion të plotësimit të standardeve bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit për specialitetet që ofrohen në shërbimin spitalor në kuadër të Reformës së Autonomisë Spitalore.
3. Evidentimi i kushteve higjieno-sanitare dhe zbatimi i legjislacionit në fuqi me qëllimi sigurimin e kushteve optimale të mësimit dhe jetesës në institucionet arsimore parashkollore, shkollore dhe universitare në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
4. Sigurimi i një sezoni turistik të sigurtë dhe të shëndetshëm me qëllim respektimin e kushteve higjieno sanitare dhe minimizimi i rasteve të intoksikacioneve alimentare dhe hidrike apo sëmundjeve të tjera infektive të lëkurës.
5. Evidentimi i derdhjeve të ujërave të zeza në zonat turistike dhe kushteve higjieno-sanitare të subjekteve akomoduese dhe restorantet me qëllim shmangien e ngjarjeve të padëshiruara në shëndetin e populates në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 55, datë 24.06.2022, "Për ngritjen e Task-Forcës Ndërinstitucionale të sezonit turistik veror 2022".
6. Inspektimi i subjekteve të furnizimit me ujë të pijshëm duke minimizuar shpërthimet e sëmundjeve infektive me origjinë hidrike.
7. Bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Policinë e Shtetit për ndalimin e tregtimit të ujit në mënyrë të paligjshme dhe në kushte jo të mira higjieno sanitare duke marë një sërë masash administrative ndaj autoboteve të ujit.
8. Gjatë vitit 2022 ISHSH ka arkëtuar të ardhura në vlerën 32,784,681 lekë nga masat administrative të vendosura në vite.
9. Përgjigja në kohë reale për të gjitha lajmërimet e kryera nga Njesitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, për persona pozitivë për COVID-19, duke mbyllur cdo ambient apo subjekt, për të parandaluar përhapjen e infeksionit.

# 4. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2023

Gjatë vitit 2023 Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, ISHSH, do të vazhdojë inspektimet në bazë të Programit të Inspektimeve 2023 të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe dakordësuar nga Inspektorati Qendror.

Objektivat të ISHSH gjatë vitit 2023 do të jenë:

- Kryerjen e 19 596 inspektimeve në respektim të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik gjatë vitit 2023.
- Inspektime për plotësimin e standardeve bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit për specialitetet që ofrohen në shërbimin spitalor në kuadër të Reformës së Autonomisë Spitalore.
- Inspektime për plotësimin e standardeve bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit për specialitet që ofrohen në shërbimin parësor.
- Inspektime para dhe gjatë sezonit turistik veror me qëllim krijimin e kushteve optimal për një sezon turistik veror të sigurt dhe parandalimin e rasteve të intoksikacioneve apo përhapjen e sëmundjeve infektive.
- Krijimi i një sistemi mbarëkombëtar gjurmueshmërie të kripës për konsum njerëzor, shtazor dhe përdorim në industrinë ushqimore.
- Inspektime për evidentimin e kushteve higjieno-sanitare në subjekte publike dhe jopublike arsimore parashkollore, shkollore, në instutucionet e arsimit të lartë, si dhe në konviktet dhe mencat e institucioneve të arsimit të mesëm dhe të lartë me qëllim sigurimine e optimumit shëndetësor të kushteve të mësimit, jetesës e shlodhjes.
- Inspektime në subjektet e furnizimit me ujë të pijshëm bazuar në vlerësimin e riskut.
- Ndryshime dhe përgatitje rregulloresh të veçanta në kuadër të përputhshmërisë së legjislacionit vendas me BE:
  - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e laboratorëve mjekësorë.
  - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve shëndetësore parësore
  - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e qendrave estetike.
  - Rregullore për subjektet akomoduese.
  - Rregullore për organizimin dhe funksionimin e subjekteve që kryejnë pastrim kimik.
  - Rregullore për subjektet akomoduese qendra kurative (llixha).
- Inspektime gjatë gjithë 2023 për monitorimin e zbatimit të ligjeve të veçanta, kompetencë e ISHSH:
  - Ligji Nr. 9636 "Për Mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit"; Ligji Nr. 8528 datë 23.09.1999 "Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji", i ndryshuar.
  - Ligji Nr. 9942 "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut", i ndryshuar.
  - Ligji Nr. 26/2017 "Për produktet kozmetike".
  - Ligji Nr. 9518 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar", i ndryshuar.
- Sigurimi i i kryerjes së inspektimeve "inteligjente" mbi bazë risku në shëndet publik dhe sipas riskut të historikut të inspektimeve.
- Mirë administrim i aktivitetit brenda sektorit juridik.
- Mirë menaxhimi i aktiveve.
- Transparencë e plotë e shpenzimeve.

- Korrupsion ZERO.
- Mirë administrim i shërbimeve të brendshme dhe burimeve njerëzore.

Frekuenca e inspektimeve zyrtare të planifikuar është në parim e përcaktuar nga numri i subjekteve të inspektimit, d.m.th i subjekteve që veprojnë në fusha të ndryshme të shërbimeve ndaj qytetarëve që veprojnë në një vënd apo rajon, të ndara sipas madhësisë bazuar në indikatorë sasiorë dhe vlerësimin e riskut që kanë shërbimet (produkti) me të cilat operojnë këto subjekte. Kjo do të thotë se për të përcaktuar numrin e inspektimeve vjetore për subjekt do të bazohemi në ndarjen si me poshtë vijon:

I. SUBJEKTE ME RISK TË MODERUAR TË CILAT DO TË INSPEKTOHEN 1 HERË NË VIT

- Kabinet Mjekësor jo publik do të inspektohen 1 herë në vit
- Qendër Mjekësore jo publike do të inspektohen1 herë në vit
- Shërbimi laboratorike mjekësor publik dhe jopublik do të inspektohen 1 herë në vit
- Kabinet Dentar jo publik do të inspektohet 1 herë në vit.
- Kabinet Dentare publik do të inspektohet 1 herë në vit
- Laboratorët Dentarë do të inspektohen 1 herë në vit
- Subjekte akomodimi me fjetje (hotele, motele, hostele, bujtina, hane, resorte, fshatra turistike, kampingje) do të inspektohen 1 herë në vit
- Pishinat do të inspektohen 1 herë në vit
- Subjektet social kulturore dhe sportive (muzetë, teatrot, kinematë, bibliotekat, palestrat, sallat e kërcimit, kampingje ditore, parqet kombëtare etj) do të inspektohen 1 herë në vit
- Institucionet e Ekzekutimit të Veprave Penale (burgjet, paraburgimi) komisariatet e policisë do të inspektohen1 herë në vit
- Subjektet e inspektuara për sigurinë në punë do të inspektohen 1 herë në vit
- Shërbime Ndërhyrëse higjieno sanitare do të inspektohen 1 herë në vit
- Subjekte importuese të DDD do të inspektohen 1 herë në vit
- Subjekte importuese të qumështit të gjirit do të inspektohen 1 herë në vit
- Bar (bar-kafe, bar-lloto, pub, disco etj) do të inspektohen 1 herë në vit

II. SUBJEKTE ME RISK TË LARTË TË CILAT DO TË INSPEKTOHEN 2 HERË NË VIT

- Spitalet publike do të inspektohen 2 herë në vit
- Spital jo publike do të inspektohen 2 herë në vit
- Poliklinikë publike do të inspektohen 2 herë në vit
- Qendër shëndetësore/pikë ambulatore shëndetësore publike do të inspektohen 2 herë në vit
- Subjektet me veprimtari jonizuese që kryhen me lëndë radioaktive dhe pajisje rrezatuese, do të inspektohen gjatë gjithë vitit.
- Institucionet arsimore (cerdhe, kopshte, shkolla fillore, shkolla 9-vjecare, shkolla të mesme, universitete, konvikte universitare etj) do të inspektohen 2 herë në vit

III. SUBJEKTE ME RISK TË LARTË TË CILAT DO TË INSPEKTOHEN 3 HERË NË VIT

- Subjektet e furnizimit me ujë (burim uji, kaptazhe, depo uji, stacione pompimi, ujësjellës, puse etj) do të inspektohen 3 herë në vit.

# 5. TREGUESIT E EFEKTIVITETIT TË ISHSH GJATË VITIT 2022

# SHTOJCA

- **BAZA LIGJORE E VEPRIMTARISË SË ISHSH.**

# BAZA LIGJORE E VEPRIMTARISË SË ISHSH

## LIGJE

- Ligj Nr. 10433, datë 16.0 6. 2011;
  Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë;
- Ligj Nr. 7643, datë 02. 12. 1992, i ndryshuar;
  Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror;
- Ligj Nr. 9636, datë 06. 11. 2006, i ndryshuar;
  Për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit;
- Ligj Nr. 10138, datë 11. 05. 2009, i ndryshuar;
- Për Shëndetin Publik;
- Ligj Nr. 9518, datë 18. 04.2006, i ndryshuar;
  Për Mbrojtjen e të Miturve nga Përdorimi i Alkoolit;
- Ligj Nr. 9942, datë 26.06.2008, i ndryshuar;
  Për Parandalimin e Çrregullimeve të Shkaktuara nga Pamjaftueshmëria e Jodit në Organizmin e Njeriut;
- Ligj Nr. 10081, datë 23.02.2009, i ndryshuar;
  Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë;
- Ligj Nr. 9952, datë 14. 7. 2008, i ndryshuar;
  Për Parandalimin dhe Kontrollin e HIV/AIDS;
- Ligj Nr. 10469, datë 13. 10. 2011, i ndryshuar;
  Për Mbrojtjen nga Rrezatimet JoJonizuese;
- Ligj Nr. 10107, datë 30.0 3. 2009, i ndryshuar;
  Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë;
- Ligj Nr. 27/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10 107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
- Ligj Nr. 8045, datë 07.12. 1995, i ndryshuar;
  Për Ndërprerjen e Shtatëzanisë;
- Ligj Nr. 8025, datë 09. 11. 1995, i ndryshuar;
  Për Mbrojtjen nga Rrezatimet Jonizuese;
- Ligj Nr. 7761, datë 19.10.1993, i ndryshuar;
  Për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse;
- Ligj Nr. 8032, datë 16.11.1995, i ndryshuar;
  Për Shërbimin e Transfuzionit dhe Kontrollin e Gjakut, produkteve të tij dhe Transplantimeve;
- Ligj Nr. 8092, datë 21. 03. 1996, i ndryshuar;
  Për Shëndetin Mendor;
- Ligj Nr. 8876, datë 04. 04. 2002, i ndryshuar;
  Për Shëndetin Riprodhues;
- Ligj Nr. 9106, datë 17. 07. 2003, i ndryshuar;
  Për Shërbimin Spitalor ne Republikën e Shqiperisë;
- Ligj Nr. 9928, date 09. 06. 2008, i ndryshuar;
  Për Sherbimin Stomatologjik ne Republiken e Shqiperise;
- Ligj Nr. 9739, datë 21. 05. 2007, i ndryshuar;
  Për Sherbimin e Transfuzionit të Gjakut ne Republiken e Shqiperise;
- Ligj Nr. 10454, datë 21. 07. 2011, i ndryshuar;

Për Transplantimin e Indeve, të Qelizave dhe të Organeve ne Republiken e Shqiperise

- Ligj Nr. 8528, datë 23. 09. 1999, i ndryshuar;
  Për Nxitjen dhe Mbrojtjen e të Ushqyerit me Gji;
- Ligj Nr. 10463, datë 22. 09. 2011, i ndryshuar;
  Për Menxhimin e Integruar te Mbetjeve;
- Ligj Nr. 10237, datë 18. 02. 2010, i ndryshuar;
  Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë;
- Ligj Nr. 8876, datë 04. 04. 2002, i ndryshuar;
  Për Shëndetin Riprodhues;
- Ligj Nr. 95/2015;
  Për Shërbimet dhe Produktet Biocide në Shëndetin Publik.
- Ligj Nr. 119/2014;
  Për të Drejtën e Informimit.

## VENDIME TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

- VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE Nr. 241, Nr. prot. 949,
  Për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shteteror Shendetesor;
- VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE Nr. 835, dt. 30.11. 2011,
  Per Miratimin e Rregullores "Për Kërkesat Higjieno-Sanitare të pishinave";
- VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE Nr. 865, dt. 24.12. 2020
  Për Mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor, e përcaktimit të tarifave dhe afateve kohore.
- VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE Nr. 798, dt. 29. 9. 2010,
  Per Miratimin e Rregullores "Per Administrimin e Mbetjeve Spitalore;
- VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE Nr. 321, dt. 28. 5. 2014,
- Per sigurine ne det, plazhe, ne ujerat e brendeshme ne thellesi te territorit dhe gjete ushtrimit te sporteve ujore";
- VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE Nr. 379, dt. 25.05.2016,
  Për miratimin e Rregullores "Cilësia e ujit të pijshëm";
- VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE Nr. 206, dt 13.3.2013,
  Për Përcaktimin e Kritereve për hapjen dhe mbylljen e Qendrave të Transplantimit;
- VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE Nr. 617, dt 12.9.2012,
  Për përcaktimin e kritereve për hapjen dhe mbylljen e bankave të indeve, të qelizave dhe të organeve;
- VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE Nr. 237, dt 6. 3. 2009,
  Për përcaktimin e kritereve për hapjen dhe mbylljen e spitaleve
- VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE Nr. 108, dt. 9. 2. 2011,
  Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me cështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë".
- VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE Nr. 632 datë 15. 7. 2015,
  Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr 108 datë 09.02.2011, të KM "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me cështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë".
- VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE Nr. 639, datë 07.09.2016,
  Për përcaktimin e rregullave, të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë.

- VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE 596 datë 04.09.2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin 639 datë 07.09.2016, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave, të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë".
- VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE Nr. 113, datë 17. 2. 2011,
  Për parandalimin e transmetimit të HIV/AIDS dhe për kujdesin, këshillimin dhe trajtimin e personave që jetojnë me HIV/AIDS në institucionet e arsimit, të riedukimit, institucionet e trajtimit mjekësor, institucionet rezidenciale të përkujdesit social, burgjet dhe vendet e paraburgimit".
- VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE Nr. 553 datë 27.07.2016 "Për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Komisioni8t të Autorizimit të Produkteve Biocide"
- VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE Nr. 487 datë, 29.06.2016 "Për klasifikimin e produkteve Biocide"

**<u>URDHËRA, UDHËZIME DHE RREGULLORE</u>**

- URDHËR I MINISTRIT TË SHËNDETËSISË Nr.103, dt. 13. 3. 2014,
  "Mbi rregullimin e procedures së marrjes së mostrës të kordonit umbilikal dhe kordonit umbilikal dhe në ruajtjen e tyre në banka jashtë territorit të vendit";
- URDHËR I MINISTRIT TË SHËNDETËSISË Nr. 416, dt 11. 10. 2011,
  "Për miratimin e rregullores për procedurat e importimit dhe eksportimit të indeve, qelizave dhe organeve me origjinë njerëzore për qëllime transplanti';
- URDHËR I MINISTRIT TË SHËNDETËSISË Nr.16, dt. 12.01.2012,
  "Për miratimin e pyetësorit për prodhimin dhe administrimin e mbetjeve spitalore";
- URDHËR I MINISTRIT TË SHËNDETËSISË Nr. 555, dt. 22. 12. 2014,
  "Për përcaktimin e grupit të gjakut dhe faktorit Rhezus D";
- URDHËR I MINISTRIT TË SHËNDETËSISË Nr. 202 dt. 23.05.2014,
  "Për autorizimin e importit të produkteve biocide dhe miratimin e listës së produkteve biocide për dezinfektim, deratizim dhe dezinsektim në shëndetin publik dhe produkteve për trajtimin e ujit të pijshën të lejuara për tregëtim dhe përdorim ne republikën e Shqipërisë".
- URDHËR I MINISTRIT TË SHËNDETËSISË Nr. 640 dt. 14.11.2008, "Për miratimin e formularëve të vetë deklarimit për subjektet që ushtrojnë aktivitet privat në fushën e shëndetësisë";
- URDHËR I MINISTRIT TË SHËNDETËSISË Nr. 49 dt. 11.02.2011,
  "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e laboratorëve mjekësorë";
- UDHËZIM I MINISTRIT TË SHËNDETËSISË NR. 184 dt. 16. 6. 1998,
  "Kërkesa për ushtrimin e aktivitetit privat për shërbimet DDD";
- UDHËZIM I MINISTRIT TË SHËNDETËSISË NR. 510 dt. 13. 12. 2011,
  "Për inspektimet higjieno sanitare në funksion të lëshimit të Akt-miratimit higjieno sanitar";
- UDHËZIM I MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE MINISTRISË SË DREJTËSISË Nr. 465 dt. 10. 11. 2011,
  "Për inspektimin higjieno sanitar në Institucionet e Ekzekutimit të Dënimeve Penale dhe të Paraburgimit";
- UDHËZIM I MINISTRIT TË SHËNDETËSISË NR. 3478 dt. 5. 5. 2014,

"Për etiketimin dhe ambalazhimin e lëndëve biocide dezinfektuese, deratizuese, dezinsektuese për përdorimin në shëndetin publik";

- UDHËZIM I MINISTRIT TË SHËNDETËSISË NR. 163, dt. 22. 4. 1996, "Për zbatimin e Ligjit për ndërprerjen e shtatëzanisë";
- UDHËZIM I MINISTRIT TË SHËNDETËSISË NR..268, dt. 10. 7. 2003, "Mbi teknikat e riprodhimit mjekësor të asistuar (RMA)".
- RREGULLORE NR. 580 dt. 16. 11. 2012, "Për shërbimin e shëndetit oral në Republikën e Shqipërisë";
- RREGULLORE HIGJIENO SANITARE NR. 2 dt. 25. 6. 1993, "Kërkesat higjieno sanitare për transportimin e produkteve ushqimore";
- RREGULLORE HIGJIENO SANITARE NR. 5 dt. 25. 6. 1993, Për marrjen e mostrave të produkteve ushqimore për analizë laboratorike";
- RREGULLORE E SHËRBIMIT SHËNDETËSORE në Institucionet Parashkollore dhe Shkollore, NR. 2560 dt. 29. 7. 1999;
- RREGULLORE HIGJIENO SANITARE për Shkollat dhe Konviktet e Ministrisë së Shëndetësisë mbështetur në Ligjin 4696 datë 07.06.1968.